



NJË VIT I BRISHTË PËR DEMOKRACINË NË PARTITË POLITIKE

RAPORT VJETOR - 2016

Afrim Krasniqi

DEMOKRACIA E BRENDSHME NË PARTITË SHQIPTARE
RAPORT VJETOR - 2016

Botimi u mundësua nga:

Fondacioni “Friedrich Ebert”

Zyra e Tiranës

Rr. „Abdi Toptani“, Torre Drin, Kati 3-të, Kutia Postare 1418

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 04 2250986 / 04 2273306: Fax: +355 04 22622067

www.fes-tirana.org

Viti i Botimit: 2017

Përpunimi grafik dhe shtyp: Albdesign PSP

ISBN: 978-9928-215-13-0

Autor: Prof. Asc. Dr. Afrim Krasniqi

Ndihmuan për punimin e këtij botimi:

Ardita Reçi

Ervin Karamuço

Silvana Jaupaj

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

■ PËRMBAJTJA

1.	Hyrje.....	5
2.	Qëllimi i monitorimit	7
3.	Metodologjia e projektit.....	8
4.	Gjetjet kryesore të monitorimit.....	9
5.	Rekomandimet kryesore.....	13
6.	Raportet mbi demokracinë e brendshme në partitë politike.....	15
	6.1. DBP në Partinë Socialiste (PS).....	15
	6.2. DBP në Partinë Demokratike (PD).....	21
	6.3. DBP në Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI).....	25
	6.4. DBP në Partinë Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU).....	27
	6.5. DBP në Partia Republikane (PR).....	28
	6.6. DBP në Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ).....	28
	6.7. DBP në partitë e vogla parlamentare	29
	6.8. DBP në partitë e reja politike.....	30
	6.9. DBP në FRESH: Risi dhe probleme.....	30
	6.10. DBP në FRPD: Risi dhe probleme.....	31
	6.11. DBP në LRI: Risi dhe probleme.....	32
7.	Partitë dhe aktiviteti zyrtar online.....	33
8.	DBP: gjetjet kryesore të partive politike në Vlorë.....	34
9.	DBP: gjetjet kryesore të partive politike në Shkodër.....	38
10.	Raport: Partitë dhe financimi.....	43
SHTOJCA:		
1.	Database www.politike.al.....	51
2.	Aktet e krijimit të partive kryesore politike.....	51
3.	Raportet e monitorimit të DBP në media.....	53

■ HYRJE

Problemet e demokracisë së brendshme në partitë politike shqiptare (DBP) janë e mbeten një tregues me rëndësi në cilësinë e demokracisë dhe pluralizmit politik në Shqipëri. Gjatë vitit 2016 pari rikthim në ligjërimin politik e publik të debatit mbi DPB si dhe tërheqjen në të një spektri të gjerë aktorësh publikë, përfshirë parti politike, media dhe grupime civile.

- Kushtetuta e Shqipërisë (neni 9) detyron partitë politike të kenë organizim në përputhje me parimet demokratike, dhe që burimet financiare e shpenzimet e tyre të bëhen kurdoherë publike. Legjislacioni mbi partitë specifikon parime e standarde që lidhen me rregullat demokratike të funksionimit, por nuk ka krijuar mekanizma institucionalë të monitorimit të zbatimit të ligjit.
- Sipas ligjit mbi partitë politike (2000, i ndryshuar 2011), çdo ndryshim në zgjedhjet e organeve drejtuese, në zhvillim të Kongreseve, në ndryshime në status dhe në program, reflektohet në dosjen përkatëse të partisë politike në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë.
- Krahas Kushtetutës dhe legjislacionit partitë politike veprojnë edhe mbi bazën e statuteve të tyre të brendshme. Çdo parti ka statut të depozituar në Gjykatë. Krahasimi midis përcaktimeve statusore dhe zbatimit të tyre praktik rezulton se ka diferencë të theksuar dhe se statuti si dokument orientues e ka humbur ndjeshëm rëndësinë dhe rolin e tij rregullator në partitë politike.
- Në Kuvendin e Shqipërisë aktualisht kemi disa parti me përfaqësim parlamentar: PS, PD, LSI, PDIU, PR, PBDNJ, PDK, PAA, LZHK, PKD, etj. Një pjesë e tyre (LZHK, PDK, PAA, si dhe pjesërisht PR e PDIU, etj janë përfaqësuar indirekt, përmes listës proporcionale të dy partive të mëdha ose janë identifikuar përmes ndryshimit të përkatësisë politike të deputetëve.

■ QËLLIMI I PROJEKTIT

Ky material monitorues dhe studimor prezantohet në kuadër të projektit mbi monitorimin e demokracisë së brendshme në partitë politike, realizuar nga Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al) dhe mbështetur nga fondacioni “Fridrich Ebert Stiftung”. Stafi i ISP monitoroi intensivisht praktikat zgjedhore, praktikat statusore dhe aktivitetin e partive politike përgjatë 2016, për të prezantuar raportin e parë mbi demokracinë e brendshme partiake (DBP) në 26 vite pluralizmit politik.

- Në funksion të projektit ISP realizoi database www.politike.al online për informacione profesionale, raporte dhe analiza, mbi partitë politike në Shqipëri, rajon dhe më gjerë. ISP publikoi të dhëna mbi historinë e partive politike, aktet e para të miratimit të secilës parti parlamentare, të dhëna historike dhe aktuale për çdo proces zgjedhor në partitë politike, analiza profesionale mbi raportet e partive me ligjin dhe evoluimin e tyre organizativ dhe identitar, etj. Database u bë burim referimi për mediat kryesore në vend, për studiuesit, për politikanët dhe për autorin e interesuar për zhvillimet politike dhe partiake në Shqipëri. Suksesi i database tregon nevojën e madhe të publikut për transparencë publike në lidhje me partitë politike, por edhe rolin dominues që partitë dhe problematikat e tyre kanë mbi debatet publike të ditës.
- Database www.politike.al reflekton edhe praktikat më të mira të DBP në vendet rajonale dhe evropiane, studimet profesionale mbi DBP, legjislacionin shqiptar dhe evropian mbi partitë politike, zgjedhjet dhe DBP, si dhe aspekte të veçanta të studimit të raportit dhe aktivitetit të partive politike.
- Rreth 30% e materialeve u siguruan përmes bashkëpunimit me Gjykatën e Shkallës I Tiranë në kuadër të ligjit mbi të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare. Në këtë kategori përfshihen vendimet e gjykatave për miratimin e subjekteve politike në vite, programet dhe statutet e para, si dhe të dhëna të tjera të depozituara në gjykatë, sipas ligjit. Një pjesë tjetër, rreth 20% e materialeve u siguruan përmes kontaktit dhe komunikimit me zyrat e organizimit të vetë partive politike. Pjesa tjetër rreth 50% u siguroa në rrugë private dhe nga individë që kryejnë studime ose kanë arkiva personale mbi partitë, legjislacionin dhe zgjedhjet në Shqipëri.
- Ky lexim i përqindjeve të burimeve vlen për të theksuar një përfundim të rëndësishëm: gjykata nuk disponon të dhënat e plota për shkak se partitë nuk respektojnë ligjin për të depozituar rregullisht në gjykatë ndryshimet e tyre periodike dhe se vetë partitë politike nuk kanë arkiv historik, nuk janë transparente dhe nuk kanë interes në publikimin e akteve të tyre online me akses të lirë publik.

■ METODOLOGJIA E MONITORIMIT

- Procesi monitorues u zhvillua në disa drejtime njëherësh: në monitorimin e akteve zyrtare të partive politike (programe, rregullore, statuse, udhëzime, etj), në monitorimin e aktivitetit praktik politik e zgjedhor të partive politike, si dhe në monitorimin specifik të partive politike në nivel kombëtar, si dhe në nivel lokal, (Vlorë e Shkodër). Pjesë e metodologjisë ishte edhe monitorimi aktiv i proceseve zgjedhore në partitë kryesore politike, monitorimi i medias në raportimet e saj mbi zgjedhjet, si dhe anketimet specifike të kryera me delegatë apo zyrtarë të ndryshëm të partive politike.
- Pjesë e raportit janë partitë kryesore politike, PS e PD, partia e tretë politike LSI, si dhe partitë e vogla parlamentare PDIU, PR, PBDNJ dhe PBKD. Gjithashtu pjesë e monitorimit janë edhe disa parti me përfaqësim indirekt parlamentar, siç janë PDK, PZHK, PAA, si dhe prurjet e reja politike SFIDA dhe LIBRA. Gjithashtu pjesë e monitorimit ishin edhe forumet rinore në tri partitë kryesore, FRESH, FRPD dhe LRI. Forumet e grave në tri partitë nuk kanë bërë zgjedhje gjatë 2016, ndaj nuk ishin objekt monitorimi aktiv dhe periodik. Qëllimi është të krijohet një panoramë e plotë e treguesve të demokracisë së brendshme në partitë politike shqiptare.

■ GJETJET KRYESORE MBI DEMOKRACINË E BRENDSHME NË PARTITË POLITIKE

1. Zhvillimet 1 vjeçare të demokracisë së brendshme në partitë kryesore kanë përforcuar sistemin vertikal dhe nominal të drejtimit. Axhenda politike prioritare ka ndikuar në kufizimin e hapësirës për debat brenda partive. P.sh, reforma në drejtësi de facto detyroi individët apo fraksionet brenda partive të unifikonin votat dhe ti largoheshin për disa muaj debateve politike të brendshme.
2. Edhe gjatë vitit 2016 bisedimet ndërpartiake, sidomos në rastin e reformës në drejtësi, u bazuan direkt përmes komunikimit të shefave të partisë, pa konsulta të rregullta me kryesinë dhe pa vendimmarrje statusore përmes kryesisë, Asamblesë apo grupit parlamentar.
3. Asnjë parti politike nuk ka respektuar statusin e saj dhe detyrimin për mbledhje periodike të Asamblesë Kombëtare / Këshillit Kombëtar, të kryesisë dhe të strukturave të tjera vendimmarrëse në parti. PD ka bilanc më negativ në këtë drejtim, kurse PS megjithëse ka më shumë mbledhje, nuk ka pasur një axhendë aktive dhe debati në këto struktura. Ato veprojnë kryesisht si tribuna politike për fjalimet e kryetarëve, kur sipas statuseve partiake, ato janë organe të tjera, janë kontrolluese dhe vendimmarrëse.
4. Partitë vijojnë të aplikojnë vendimmarrje kryesisht nominale (me urdhra, porosi, udhëzime, etj) duke evituar aktet e shkruara statusore publike. Humbja e “gjurmëve” përbën devijim nga fryma e ligjit mbi partitë politike dhe rregullat e funksionimit të tyre, të cilat detyrojnë partitë të bëjnë publike të gjitha vendimet dhe aktet politike.
5. Praktikant statusore të demokracisë së brendshme vijojnë të jenë formale; partitë aplikojnë standarde extra në trajtimin real me kritikët e vijës zyrtare, shumica e tyre jashtë përcaktimit statusor dhe në formë të personalizuar të marrëdhënieve midis kryetarit dhe kritikëve.
6. Zhvillim pozitiv gjatë 2016 ishte tendenca e partive kryesore për t’iu rikthyer formave të trajnimit dhe edukimit politik e demokratik. PS riktheu praktikën e aktiviteteve trajnuese me Fondacionin “Qemal Stafa”, PD aplikoi për herë të parë Akademinë Politike me “Fondacioni për Liri dhe Demokraci, si dhe LRI me akademinë rinore në Jalë. Gjithashtu edhe partitë e tjera më të vogla janë përfshirë rregullisht në aktivitete trajnuese kombëtare e ndërkombëtare të zhvilluara në Tiranë. Meritë të veçantë në këtë aspekt kanë fondacionet politike ndërkombëtare që asistojnë partitë politike, siç janë Fridrich Ebert, Konrad Adenauer, National Democratic Institute, Hanns Seidel, etj.
7. Me ligjin mbi të drejtën e informimit (2014) çështja e transparencës publike është bërë kriter vlerësimi dhe standard minimal për çdo institucion publik dhe indirekt, edhe për partitë politike si organizata që kryejnë aktivitetet ligjor publik dhe kanë funksionarë publikë. Vetë partitë janë promovuese dhe monitoruese aktive të këtij ligji, por brenda atyre, ato refuzojnë të jenë subjekt i ligjit dhe nuk kanë përmbushur as standardet minimale të zbatimit të tij. Partitë janë të mbyllura për publikun dhe refuzojnë transparencën dhe llogaridhënien publike.
8. Legjislacioni shqiptar mbi partitë politike është i paplotë dhe konfuz. Nga monitorimi i kryer nga ISP vetëm 12 nga 126 partitë politike të regjistruara në gjykatë kanë raportuar periodikisht ndryshmet që kërkohen nga ligji. Pjesa tjetër e partive e ka injoruar detyrimin ligjor, disa parti politike figurojnë ende aktive me drejtues të cilët as nuk jetojnë më. Fiktiviteti i partive politike pranohet edhe nga KQZ, organ i cili në raportin vjetor 2015 thekson se nga 118 parti politike të cilat duhet të auditoheshin, 71 parti politike nuk u arrit të kontaktoheshin nga ekspertët kontabël të kontraktuar nga Komisioni.
9. Reforma në drejtësi përcakton kriterin se kandidatët për gjyqësor nuk duhet të kenë qenë 10 vitet e fundit në strukturat drejtuese në partitë politike. Me ligjin mbi partitë dhe mënyrën e funksionimit të tyre, si dhe me informacionet formale në faqet zyrtare është e pamundur të përmbushet

kjo kërkesë, pra të bëhet verifikimi se cilat kanë qenë strukturat partiake gjatë dekadës së fundit. Partitë nuk deklarojnë në gjykatë ndryshimet e strukturave, vetëm emrin e kryetarit dhe adresën e partisë, - një informacion pa rëndësi në konceptin tërësor të transparencës publike dhe kërkesave të legjislacionit për reformën në drejtësi.

10. Referuar standardit minimal të informimit publik, 97% e partive nuk kanë faqe interneti, nuk kanë media dhe as burime të tjera publike informimi mbi programin, strukturat, aktivitetin dhe të dhënat e tyre. Asnjë parti nuk ka të publikuar online rezultatet zgjedhore të tyre, strukturat lokale, strukturat e gjykatave statusore brenda partisë, ndryshimet statusore e programore, rregulloret, etj. Ato i konsiderojnë këto si çështje të brendshme partiake, kur në fakt janë e mbeten çështje me interes publik. Partitë kryesore parlamentare: PS, PD, LSI, PDIU kanë faqe interneti, pjesërisht të përditësuar. Partitë e tjera në parlament PDK, PBDNJ, PBDNJ, PR, etj, kanë faqe in-aktive interneti, kurse partitë e mbetura nuk kanë adrese efektive në internet.
11. Në partitë kryesore (PS, PD, LSI) dominojnë njoftimet zyrtare mbi aktivitetet dhe deklaratimet publike të kryetarit dhe stafit drejtues, por mungojnë përditësimet mbi aktivitetin e strukturave të tjera, si dhe mungojnë tërësisht mendimet kritike që shfaqen nga individ apo fraksione në parti, edhe kur këto të fundit janë headline në median e shkruar dhe vizive. Partitë po identifikohen gjithnjë e më shumë me emrin e liderit politik dhe ky tipar negativ, reflekton edhe natyrën disproporcionale midis lajmeve që prodhojnë partitë mbi kryetarin dhe lajmit mbi pjesën tjetër të partisë.
12. Aktiviteti kryesor i partive është adresuar në rrjetet sociale, të cilat krijojnë audiencë të gjerë, por nuk kanë vlerën e referimit, të arkivit të qëndrueshëm dhe të fakteve. Rrjetet sociale përdoren kryesisht për denigrimin e palës tjetër dhe fushata sensibilizimi, jo për rrjete konsultimi, komunikimi dhe shkëmbimi opinionesh mbi qëndrime të caktuara politike. Ato kanë kosto minimale, krijojnë headline në media, promovojnë liderit politikë, mbështeten nga grupet militante mbështetëse, por duke qenë virtuale dhe abuzive, nuk lënë “gjurmë” të qëndrimeve politike në memorien ndaj liderit ose partisë, ose vazhdimisht retushojnë lajmet në varësi nga interesat e ditës.
13. Në faqet zyrtare të secilës parti politike nuk gjenden asnjë nga aktet e miratuara zyrtare të kryesisë, udhëzimet e kryetarëve, raportet e monitorimit dhe analizës, dhe as aktet e propozuara për debat në anëtarësi, as draft-programe dhe draft-ide mbi të cilat mund të diskutojnë dhe japin mendime anëtarësia/strukturat vertikale. Arkivat partiake janë të mbyllura për publikun, ndaj edhe pamundësia për njohjen mbi aktet zyrtare pamundëson edhe monitorimin e ligjshmërisë dhe cilësisë në përgatitjen dhe jetësimin e tyre.
14. Në faqet e internetit të secilës parti mungon tërësisht informacioni historik i aktivitetit të tyre, të dhënat mbi zgjedhjet në vite apo mbi strukturat drejtuese, të dhënat për burimet e financimit apo për raportet me partnerët vendor e të huaj. Raportet e financimit dhe aktivitetit janë formale, por edhe pa mekanizma verifikimi. Partitë paraqiten shumë më të varfra sesa janë, dhe duke përfituar nga boshllëku ligjor, krijojnë sistem fiktiv raportimi vjetor.
15. Në faqet e internetit të PS, PD, LSI, etj, nuk ka publikime të aktualizuara mbi numrin e anëtarësisë, adresarin e degëve në rrethe, adresa kontakti apo të dhëna të tjera që përbëjnë standardet minimale të ligjit për të drejtën e informimit publik. Mungesa e detyrimit ligjor për anëtarësi dhe e database mbi anëtarësinë, si dhe e mekanizmave që monitorojnë saktësinë e kësaj baze, shoqërohet me procese fiktive ose të kontestuara votimi në nivele lokale dhe qendrore të partive.
16. Në faqet e internetit të PS, PD, LSI, etj, nuk janë publikuar të dhënat bazë (status, program, zgjedhje, kryesi, rregullore, praktika pune dhe vendimmarrjeje) që lidhen me organizatat e tyre partnere, forumet rinore dhe forumet e grave. Nuk ka asnjë rast të vetëm kur një forum politik rinor apo gra/vajza të vetë-organizohet dhe të krijojë identitet publik, por në tërësi dominon praktika, sipas të cilës, organizatat partnere janë avokate besnike e kryetarit të partisë, dhe për pasojë, edhe të kontrolluara prej tij.

17. Nga të gjitha partitë parlamentare, vetëm PD ka publikuar listat e Këshillit Kombëtar. Partitë e tjera, përfshirë PS e LSI nuk kanë të dhëna publike mbi anëtarët e Asamblesë Kombëtare/Komitetit Drejtues. Nga verifikimi i listave rezulton se një numër zyrtarësh kanë mospërputhje të angazhimit politik me statusin e tyre ligjor si nëpunës civilë ose funksionarë publikë, siç rezulton edhe se tradicionalisht, partitë në opozitë kanë më pak shkelje në këtë drejtim edhe për shkak se zyrtarët e saj kryesisht janë të papunë ose në aktivitete joqeveritare.
18. Në partitë shqiptare, ndryshe nga hierarkia statusore e miratuar në gjykatë, organizimi politik po ecën në drejtim të centralizimit vendimmarrës, kryesisht, përmes krijimit të strukturave paralele (kryesi dhe sekretariat, koordinatorë dhe të ngarkuar me punë, kryesi e vogël dhe kryesi e madhe, grup parlamentar dhe kryesi, etj) ose përdorimit të kuotave (kuotave gjinore dhe rinore) si mekanizëm kufizimi për kandidatët e karrierës që janë jashtë këtyre kuotave.
19. Në dokumentet statusore të partive citohen strukturat dhe mandatet legjitime të tyre, por partitë kryesore vitet e fundit po aplikojnë sistemin e veprimit politik dhe ekzekutiv përmes strukturës së grupit parlamentar, strukturë pa vend të rëndësishëm në dokumentet statusore, dhe me problematika funksionimi, për shkak se një pjesë e deputetëve nuk janë domosdoshmërisht anëtarë partie. Kryetarët e partisë dhe jo kryetari i grupit e drejton mbledhjen e grupit parlamentar, kurse grupet parlamentare të PDIU dhe PR janë fiktive, me deputetë të dhuruar nga dy partitë e mëdha, respektivisht, PS e PD.
20. Partitë reflektojnë mungesën e mekanizmave të brendshëm gjykues dhe zgjidhës të mosmarrëveshjeve midis strukturave dhe individëve me status politik. Paralajmërimi për përjashtimin e dy deputetëve kritikë në PS, e tre deputetëve kritikë në PD dhe përjashtimi i një deputeti tek LSI tregoi se asgjë nuk i pengon liderit politik ta bëjnë këtë, me përjashtim të kostos elektorale që mund të kenë. Në secilin rast komisionet dhe strukturat e garancive statusore, pra gjykatat e brendshme statusore, ishin jo funksionale dhe mbetën të tilla.
21. Me gjithë angazhimin e partive politike për të aplikuar në radhët e tyre standardet e de-kriminalizimit në proceset e brendshme zgjedhore dhe promovuese, ende as PS, as PD, as LSI dhe asnjë parti tjetër nuk kanë zhvilluar mbledhjet inauguruese të trupës që duhet të bëjë kontrollin & vlerësimin.
22. Asnjë parti politike nuk ka miratuar ende vendime të posaçme, të cilat, bazuar në dokumentet statusore, aplikohen në rastet kur personat arrestohen, dënohen, kryejnë vepra penale, shkelin kodet e etikës apo janë objekt i ligjit të de-kriminalizimit. Edhe në rastet e skandaleve publike (skandalet nga mediat, shkarkimet nga postet, arrestimet, ndalimet, dorëheqjet për shkak të skandalit, etj) të zyrtarëve që mbajnë funksione partiake, vetë partitë nuk kanë vepruar, nuk kanë hequr zyrtarisht mbështetjen politike dhe kështu, nuk kanë zbatuar përgjegjësitë statusore dhe as standardet e larta që ato kanë premtuar në debatin mbi dekriminalizimin.
23. Me gjithë detyrimin kushtetues (neni 9) që partitë politike bëjnë kurdoherë publike burimet e financimit, me përjashtim pjesërisht të LSI asnjë parti tjetër politike nuk bën publike të dhënat financiare kryesore (shpenzimet për aktivitete publike).
24. Partitë e vogla politike kanë nisur lëvizjet brenda tyre dhe në raport me partitë e mëdha, kryesisht në përpjekje për kalkulime elektorale në pranverën 2017, dhe gjithnjë mbi baza preferencash personale të drejtuesve të tyre.
25. Defektet organizative dhe të standardeve minimale të demokracisë së brendshme partitë politike i reflektojnë edhe në organizatat e tyre satelite, forumet rinore dhe forumet e grave. Tendencat për kontrollin e plotë të këtyre organizatave, e kufizimit të fushëveprimit të tyre dhe e shndërrimit të tyre në trupa besnike të kryetarëve, përbën një tipar shqetësues dhe dominues gjatë dekadës së fundit.

26. Strukturat rinore të partive janë dhe mbeten aktive, megjithatë ato më shumë se përfaqësuese të brezit të ri shfaqen si imituese dhe avokate të zjarra të pikëpamjeve e qëndrimeve të kryetarëve të partive respektive, duke dëmtuar ndjeshëm forcën përfaqësuese, autonominë dhe aftësinë e ofertave për ndryshime në politikë. Të rinjtë në politikë nuk ofrojnë garanci e tregues se kanë mentalitet më liberal dhe janë më të hapur e konkurrues sesa partitë mëma, gjë që reflekton edhe problematikën e demokracisë së brendshme në nivel kapilar në partitë politike.
27. Forumet e grave në partitë politike **në përgjithësi** nuk zhvilluan zgjedhje gjatë 2016, dhe nuk shënuan aktivitete të rëndësishme kombëtare. Ato vijojnë të jenë të drejtuara nga politikane të imponuara nga lidershipi i partisë, modeli i tyre funksional nuk ofron një model tjetër nga ai i vetë partive politike. Sistemi i kuotave dhe angazhimi për rritje të politikave gjinore do të duhej të shoqërohej me modele pozitive funksionimi dhe aktiviteti nga forumet e grave.

REKOMANDIME

1. Ligji mbi partitë politike ka nevojë emergjente të amendomet në disa pika të rëndësishme, që kanë të bëjnë me detyrimin e partive për të depozituar çdo vit në gjykatë gjendjen faktike të tyre, strukturat drejtuese dhe të dhënat mbi provat/selinë. Baza ligjore duhet të mundësojë partitë inekzistente dhe të krijojë një hapësirë më konkurruese dhe më cilësore midis partive me mbështetje reale elektorale.
2. Ligji i partive politike ose Kodi Zgjedhor, duhet të parashikojë krijimin e një zyre mbi partitë politike në KQZ, me funksion bazë monitorimin e regjistrimit të partive politike dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nga vetë partitë politike. Partitë që shkelin ligjin, duhet të jenë objekt penalizmi publik, një praktikë që deri tani nuk ka ndodhur.
3. Ligji i partive politike dhe Kodi Zgjedhor duhet të amendohet në çështjet që kanë të bëjnë me financimin elektorale dhe financimin partiak, për rregullimin e mekanizmave që mundësojnë transparencë dhe kontroll demokratik të financave, sipas përcaktimit të Kushtetutës. Vetë partitë duhet të publikojnë të dhënat financiare vjetore në faqen zyrtare online, donatorët dhe detyrimet financiare, në mënyrë që koncepti i transparencës të jetë real dhe i monitorueshëm.
4. Partitë duhet të publikojnë çdo vit numrin e saktë të anëtarësisë, jo vetëm si tregues transparence, por edhe për të bërë të mundur rakordinimin e saktë midis anëtarëve dhe kuotave financiare që mblidhen çdo vit prej tyre.
5. Partitë politike duhet të miratojnë kodin e praktikave të mira dhe standardet më të larta të partive simotra në EPP/PES, për publikim të rregullt të të gjitha akteve partiake, programeve, statuseve, rregulloreve, mendimeve të pakicës dhe vendimmarrjet në çdo praktikë votimi. Aktet individuale nuk duhet të tejkalojnë ose zëvendësojnë rëndësinë e akteve zyrtare legjitime, të miratuara nga struktura statusore dhe për rrjedhojë, nga struktura të njohura nga ligji.
6. Partitë duhet të dëshmojnë vullnet të qartë për të jetësuar strukturat e brendshme të etikës, në përputhje me detyrimet që burojnë nga legjislati mbi de-kriminalizimin, të krijojnë adresat publik mbi mbledhjet dhe vendimmarrjet dhe të promovojnë ndërgjegjësim më të madh tek anëtarët dhe strukturat e tyre për promovimin e vlerave në parti. Individët e përfshirë në skandale dhe objekt i ligjit të de-kriminalizimit, duhet të përjashtohen nga çdo strukturë përfaqësuese në partitë politike.
7. Partitë duhet të respektojnë kodin e punës, ligjin e nëpunësit publik, statusin e administratës, dhe akte të tjera ligjore, të cilat lidhen sa me ndarjen e qartë të angazhimeve partiake me statusin civil publik, ashtu edhe me evitimin e konfliktit të interesit midis anëtarëve të strukturës dhe funksionit të tyre ekzekutiv në shtet.
8. Partitë politike duhet të plotësojnë në standarde normale të dhënat historike dhe aktuale mbi to, strukturat, dokumentet dhe jetën partiake, në faqet respektive të internetit. Ato duhet ti shndërrojnë faqet e internetit në modele transparence, për një raport më të mirë dhe më të besueshëm midis vetë partive, publikut dhe qytetarëve votues.
9. Partitë duhet të vijojnë praktikën pozitive të trajnimeve politike e demokratike për strukturat e tyre, sidomos për strukturat lokale dhe rinore, në mënyrë që të jenë të afta për të ndërtuar strategji të suksesshme politike, për të forcuar konkurrencën rreth ideve dhe projekteve si dhe për ti paraprirë masave votuese me vizion dhe kthjelltësi.
10. Partitë duhet të angazhohen për jetësim praktik të strukturave gjyqësore brenda atyre, për çlirim të anëtarëve të këtyre njësive nga konflikti i interesit, rritjen e integritetit të tyre dhe sigurimin e rrethanave reale për mundësimin e funksionit negociues dhe gjykues për të gjitha mosmarrëveshjet në parti, midis strukturave si dhe midis anëtarëve dhe partisë.

11. Partitë duhet tu sigurojnë kushte e rrethana jo diskriminuese politikanëve dhe zërave kritikë brenda tyre, duke e konsideruar kritikën dhe mendimin ndryshe një pasuri për jetën e një partie politike dhe një katalizator e test për më shumë demokraci të brendshme.
12. Partitë duhet të krijojnë një strukturë të brendshme monitoruese për respektimin e normave statusore, dhe çdo vit, duhet të raportojnë në strukturat vendimmarrëse (Asamble/Këshill) mbi problematikat e funksionimit të dokumenteve statusore dhe rregulloreve të punës.
13. Partitë duhet të trajtohen si subjekte publike dhe me interes publik, për të qenë objekt zbatimi i ligjit mbi të drejtën publike, për shkak të rëndësisë që ato kanë në jetën politike të vendit dhe për shkak të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji mbi partitë politike. Çdo qytetar i interesuar duhet të lejohet të komunikojë me partitë dhe të marrë prej saj informacione me interes publik, politik e administrativ, të cilat nuk përbëjnë problem të brendshëm të vetë partive politike dhe as cenojnë taktikat e saj elektorale.
14. Partitë duhet të miratojnë akte të etikës, të cilat refuzojnë gjuhën e urrejtjes, denigrimit ndaj mendimit kritik ose Tjetrit, si dhe të promovojnë përmes programit dhe aktivitetit ditor, standarde më të larta të sjelljes demokratike dhe të kulturës qytetare.
15. Partitë duhet të krijojnë frymë tolerante dhe konkurruese në organizatat partnere të tyre, në forumet rinore dhe forumet e grave, përmes financimit të veçuar dhe autonomisë vendimmarrëse duhet tu krijojnë atyre mundësinë e ekzistencës dhe aktivitetit pa ndërhyrje direkt nga lart, si dhe të promovojnë në këto organizata vlera të cilat konsiderohen të brishta në vetë partitë politike.
16. Partitë duhet të publikojnë çdo vit broshura, raporte, të dhëna përfaqësuese, etj, mbi aktivitetin, identitetin dhe pozicionin e tyre politik, si një detyrim moral ndaj votuesve, qytetarëve dhe shtetit, por edhe si një kontribut e ndihmë për dokumentacion historik, në ndihmë të studiuesve, medias dhe studentëve.

■ RAPORT MBI DEMOKRACINË E BRENDSHME NË PS

Viti 2016 shënoi zhvillime të rëndësishme në aspektin e organizimit dhe demokracisë së brendshme në Partinë Socialiste. Prej vitit 2013, kur PS erdhi në pushtet, ajo nuk kishte zhvilluar zgjedhje të brendshme për strukturat drejtuese dhe as nuk kishte pasur debate e probleme funksionimi në vendimmarrje. Gjatë 2016 PS u përball me të dy këto aspekte: me zgjedhje të reja në strukturat drejtuese lokale dhe qendrore, si dhe me debate të brendshme, të cilat kulmuan në krijimin e një fraksioni të ri politik me dy deputetë, figura të rëndësishme të saj.

DEBATI MBI MANDATIN E KRYETARIT – REFERENDUMI NË PS

Sipas vendimit të Asamblesë Kombëtare (2015) Kongresi Zgjedhor i PS do të mbahej në fundin e janarit 2016, por vonesat në organizim dhe përgatitje e shtynë atë për më 19 mars 2016. Vendimi për shtyrjen, si dhe sidomos vendimi për të mos përfshirë në rendin e ditës së Kongresit zgjedhjen e kryetarit të PS me parimin “1 anëtar – votë” shkaktoi kritika tek disa nga eksponentët politikë në PS. Zoti Rama, kryetari i PS, është zgjedhur në këtë post në shtator 2009 dhe mandati i tij statusor skadoi në shtator 2013. Prej atëherë PS iu shmang detyrimit statusor dhe mandati i kryetarit u zgjat pa vendimmarrje statusore deri në mars 2016, pra 3 vjet më shumë sesa mandati statusor zgjedhor.

- Kongresi i 19 marsit në PS u dominua nga debati mbi normat statusore dhe organizimin partiak. Një pjesë kritike brenda grupit parlamentar dhe tetë anëtarë të Asamblesë, përfshirë ish kreu i grupit parlamentar Ben Blushi, ish Presidenti Rexhep Meidani, ish kandidati për kryetar përball Ramës më 2009, Maqo Lakrori, si dhe politikanë të tjerë aktiv (Dade, Hafizi, etj) ose të tërhequr nga politika aktive (Legisi, Bello, Ago, etj), mbështetën nevojën e PS për rikthim në shtratin statusor, zgjedhjet e reja për kryetarin dhe garë konkurruese në çdo nivel të partisë. Ata hartuan një memorandum publik, më tej me një tjetër dokument zyrtar bënë publike të gjitha shkeljet statusore, si dhe propozuan me shkrim (sipas statusit) ndryshime në rendin e ditës së Kongresit. Ankesa e tyre në komisionin e Garancive Statusore u shqyrtua, por kërkesat në ankesë u rrëzuan. Pas Kongresit drejtuesi i këtij Komisioni u emërua në një detyrë të lartë zyrtare në varësi të kryeministrit.
- Në thelb, asnjë prej propozimeve dhe kritikave të pakicës kritike në PS nuk u mor në konsideratë nga kryetari, kryesia, Asambleja dhe as Kongresi. Përkundrazi, në aktivitetet lokale, sidomos në Elbasan, zëri kryesor kritik, Blushi, u kërcënuar publikisht nga një grup militantësh dhe PS nuk bëri distancim formal dhe as politik prej tyre. Incidente më të vogla u shfaqen edhe në disa degë të tjera lokale.
- Muaji mars 2016 u shoqërua me praktikën zgjedhore nëpër degë për zgjedhjen e delegatëve për në Kongres. Pavarësisht se statusi përcakton praktika unike, në praktikë pati diferencë midis praktikave dhe kriterëve të aplikuar. Për shembull, në qarqet Vlorë, Gjirokastër, etj, u mor në konsideratë pajtueshmëria me dy mandate, duke konsideruar mandat të parë qenien drejtor apo funksionar në nivele drejtuese lokale. Gjithashtu PS u përfshi në një aksion publik për pranime të reja në parti, sidomos nga të rinj të moshës 18-23 vjeç. Për rrjedhojë, një pjesë e madhe e delegatëve ishin


PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË
 KOMISIONI I ZGJEDHJEVE I PARTISË
FLETË VOTIMI PËR REFERENDUMIN
 9 PRILL 2016
 Çështja që shtrohet për referendum:
 Kur Partia Socialiste është në qeveri
 dhe Kryetari i saj është i zgjedhur Kryeministër
**A konsiderohet i rinovuar automatikisht
 mandati i Kryetarit?**
PO **JO**
KOMISIONI I ZGJEDHJEVE I PARTISË TË NJA
 NËNKRYETAR KRYETAR

të rinj në përvojë e moshë. ISP kreu një hulumtim (pyetësor) me delegatët e PS në Kongres, prej nga nxori të dhëna interesante, që tregonin natyrën vertikale të vendimmarrjeve në PS dhe nga ana tjetër, dëshirën e delegatëve për një vendimmarrje më përfshirëse dhe më horizontale.

Zyrtarisht në rastin e referendimit u njoftua se PS ka 81.752 anëtarë, ndërkohë që në deklarinimin 2014 dhe 2015 në KQZ mbi burimet e financimit (kuotat) PS kishte deklaruar 104-105 mijë anëtarë, pra rreth 23-24 mijë më shumë sesa anëtarësia që u referua për zgjedhjet në parti dhe për përfaqësim në Kongres. Pakica kritike në parti, përfshirë dy deputetë, duke akuzuar për manipulime dhe fiktivitet kërkuan zyrtarisht nga PS listat zyrtare të anëtarësisë dhe dokumentet provë të votimit, por kërkesa e tyre është refuzuar. ISP monitoroi formalisht tri procese votimi në votimin e delegatëve dhe në referendimin e PS (duke numëruar personat që hynë në qendër votimi përgjatë ditës së votimit) dhe rezultoi se numri i personave votues ishte dukshëm disproporcional (shumë herë më e vogël) sesa shifra zyrtare që organet zgjedhore të partisë njoftuan në përfundim të procesit.

- Kongresi i 19 marsit vendosi zhvillimin me 9 prill të një referendumi në parti, me pyetjen: *“kur PS është në qeveri dhe kryetari është i zgjedhur kryeministër a konsiderohet i rinovuar automatikisht mandati i kryetarit?”*. Kongresi bëri edhe ndryshime të rëndësishme statusore, sidomos në lidhje me mandatin e kryetarit, duke e lidhur jetëgjatësinë e tij me postin e kryeministrit ose daljen e PS si parti e parë në zgjedhjet parlamentare. Edhe në këtë rast, pjesa kritike e kryetarit të PS dhe linjës së tij zyrtare, publikoi një dokument me 20 arsye bojkoti të referendimit, por dokumenti nuk u mor në konsideratë nga strukturat drejtuese.
- Kongresi u shoqërua me debat midis shumicës dominuese pro kryetarit (Rama) dhe pakicës pro kritikut të tij kryesor (Blushi), si dhe u miratuan me vota qëndrimet politike, propozimet dhe aktet e tjera të ofruara nga linja zyrtare e PS-së. Në dallim nga praktikrat e tjera të kongreseve normale (jo në periudhë zgjedhore) Kongresi i PS 2016 u dominua nga imazhi dhe unifikimi drejt liderit politik. Një numër i madh delegacionesh përfundimor morën pjesë direkt/indirekt në Kongres me mesazhet e tyre mbështetëse.

ZGJEDHJET NË PARTI, - DOMINUES VOTIMI PA KANDIDATË RIVALË

Pas Kongresit PS vijoi plotësimin e strukturave drejtuese qendrore. Figurat më të rëndësishme politike, - sekretariati, - u votua pa kandidatë rivalë, pra me vetëm një emër në fletën e votimit. Kjo praktikë votimi përbën një zhvillim negativ në aspektin e demokracisë konkurruese në PS dhe një tregues i kontrollit të plotë të kryetarit Rama mbi strukturat e PS.

- Asambleja zgjodhi edhe 7 sekretarë (nga 9 sekretarë më 2009). U rikonfirmuan Ruçi, Fino, Beqaj dhe u zgjodhën të rinj Peza, Kokëdhima, Spiropali dhe Ulqini. PS vendosi të shkrijë sekretarin për zgjedhjet me atë për koordinimin në një të vetëm, si dhe sekretariatën për burimet njerëzore me atë për koalicionin në një të vetëm. Sekretari për biznesin u shkri tërësisht, kurse disa sektorë të tjerë u ri-ndarë ose u ri-bashkuan me njëri tjetrin. Me strukturën e re sekretariati i PS përbëhet nga sekretari i Përgjithshëm, si dhe sekretarët për organizimin administrativ, organizimin digjital, burimet njerëzore dhe marrëdhëniet me koalicionin, për koordinimin elektoral, për rininë, për programin dhe për reformën strukturore e emigracionin.
- Kongresi votoi edhe Asamblenë e re Kombëtare, me formulën e ndarjes sipas së përfaqësimit sipas qarqeve. Asambleja e Re u mblodh me 25 prill 2016 dhe zgjodhi kryesinë dhe sekretariatën e ri. Në mbledhje dhe votim morën pjesë 271 anëtarët e Asamblesë. Kryesia u rinovua me rreth 50%, por nga pjesa që nuk është më në kryesi vetëm dy (Besnik Bare dhe Eduard Shalsi) nga 11 ishin në konkurrim. Nëntë anëtarë të kryesisë nuk rikandiduan (Ben Blushi, Mimoza Hafizi, Shkëlqim Cani, Arben Isaraj, Ndre Legisi, Gentian Bejko, Luljeta Arapi, Arben Malaj), kurse dy figura me përvojë në PS, Namik Dokle e Arta Dade dhanë dorëheqje nga kandidimi, i pari në emër të rinovimit, e dyta në shenjë pakënaqësie më praktikrat zgjedhore në PS. Në votim ishte edhe Olta Xhaçka, kryetare e organizatës së gruas në PS, post i cili, si rregull kooptohet pa votim.
- Në vijim të organizimit, në tetor PS caktoi edhe drejtuesit politikë të qarqeve: Tahiri (Tiranë),

Ruci (Fier), Balla (Elbasan), Dako (Durrës), Gjikhuri (Vlorë), Peleshi (Korcë), Bushati (Shkodër), Klosi (Berat), Nikolla (Lezhë), Kodheli (Dibër), Çuçi (Gjirokastrë) dhe Beqja (Kukës). Praktika e caktimit të tyre u bë gjithashtu pa votim, dhe me disa risi: nga qarku i Vlorës u largua ish deputeti Koço Kokëdhima, i cili në Asambledë e fundit të PS ishte zgjedhur Sekretar për Reformën Strukturore dhe Emigracionin. Po ashtu lëvizje të tjera si në Durrës, Berat, Vlorë, etj, tregojnë ndryshimin e raporteve në krye të PS në favor të personave të përzgjedhur.

- Në tetor gjithashtu PS shpalli skemën e re të organizimit, bazuar në ndarjen e re territoriale, dhe në funksion të zgjedhjeve parlamentare 2017. Sipas skemës, përveç koordinatorëve në qarqe, do të ketë edhe 61 koordinatorë në nivel bashkish, 90 koordinatorë në nivel KZZ, 386 koordinatorë në nivel të njësisë lokale brenda bashkive, si dhe rreth 5300 koordinatorë mbi bazën e qendrave të votimit. PS ishte e para parti politike që, në këtë mënyrë, filloi përgatitjet organizative konkrete për fushatën elektorale në zgjedhjet parlamentare 2017.

VENDIMMARRJA GJITHNJË E MË VERTIKALE NË PS

Pas Kongresit Kombëtar dhe Referendimit mbi debatin e zgjedhjeve të brendshme në parti, Partia Socialiste nuk ka zhvilluar aktivitete të tjera kombëtare me natyrë organizative. Gjatë periudhës së verës, kryesisht për shkak të reformës në drejtësi dhe problemeve në koalicionin qeverisës, kryesia e re e PS është mbledhur disa herë, - në numër, shumë më tepër sesa gjatë dy viteve të fundit të marra së bashku. Një mbledhje Asambleje u zhvillua më 1 tetor, e nxitur edhe nga një protestë masive në Tiranë kundër rikthimit të ligjit për importimin e mbetjeve.

- Asambleja e PS e tetorit 2016 miratoi disa akte zyrtare organizimi, të cilat përbëjnë një zhvillim pozitiv në aspektin dokumentar, si dhe plotësojnë vendimmarrjet e nisura në mars. U miratuan disa rregullore të reja: mbi organizimin e funksionimit të Asamblesë Kombëtare të PS, Mbi Sekretariatit Ekzekutiv, Mbi Komisionin e Garancive Statusore dhe Etikës, Mbi Kryefinancierin, financierët dhe Këshillin e Mbikëqyrjes Financiare, Për votëbesimin në parti, Mbi dokumentacionin në parti dhe administrimin e tij, Manualin e organizimit elektorale, Kodin e zgjedhjeve në parti, Kodin e etikës në parti, si dhe Vendimin për kuotat e anëtarësisë së partisë për vitin 2016.
- Kryesia e re 2016 vendosi edhe për hapjen e procesit zgjedhor për kryesitë dhe kryetarët e PS në të gjitha qarqet e vendit. Procesi zgjedhor u mbajt në datat 27, 28, 29 maj dhe reflekton prurjet e reja në parti dhe tendencat e rinovimit të partisë në aspektin sasior dhe moshor, në prag të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Në shumë prej degëve pati vetëm një kandidat në garë, duke eliminuar nga lart (kryesia qendrore) kandidatët e tjerë, gjë që solli reagim negativ (votë kundër) ndaj kandidatit zyrtar në votimet e PS për kryetar në njësi si Përmeti apo Vau i Dejës¹. Imponimi nga kryesia qendrore në seleksionimin e kandidatëve, promovimi i figurave të reja dhe sidomos i grave/vajzave ishin dukuri e procesit zgjedhor lokal në PS.
- Gjatë vitit PS lajmëroi zgjedhje të reja në disa degë të reja dhe korrigjime organizative në disa të tjera, por ende nuk ka ende një plan konkret organizativ dhe as një akt jetësimi të kësaj vendimmarrjeje politike. Disa akte periferike u shënuan kryesisht në zona ku pati debate të brendshme partiake (veçanërisht në Shkodër dhe në Vlorë), por mungojnë rezultatet që mundësojnë një analizë më cilësore.
- Pas fazës së parë (muajt e parë pas Kongresit), kryesia nuk pati mbledhje të rregullta mujore, por u mbledh vetëm në raste të vendimmarrjeve (skemës organizative) ose problemeve të krijuara me reformën në drejtësi. Gjithashtu Sekretariati i PS, një organ ekzekutiv dhe me rëndësi në strukturën organizative të kësaj partie, nuk pati mbledhje të rregullta dhe publike, - madje, në

¹ Në Përmet 30 nga 54 anëtarët e Asamblesë i drejtuan kryesisht së PS-së, ku kërkonin që të lejoheshin të konkurronin përmes votës të tre kandidatit të përzgjedhura në datën 13 maj 2016, nga kryesia e Qarkut Gjirokastrë. Kërkesa e tyre nuk u mor në konsideratë. Kryesia miratoi vetëm një kandidat, ndaj në votimin për kryetar shumica (24 anëtarë) votuan kundër, dhe vetëm 19 pro. Në Vau i Dejës kandidati i vetëm mori 27 vota pro dhe 30 kundër, kurse në zona si Malësia e Madhe kandidati i vetëm u votua me 99.7%, në Delvinë, Konispol, Finiq, Dropull kandidati zyrtar fitoi me 100%, asnjë votë kundër, në Elbasan nga 233 vota vetëm 3 ishin kundër, etj.


pjesën më të madhe edhe të takimeve të tij të zhvilluara, nuk pati pjesëmarrje të rregullt. Njëri prej sekretarëve (K.Kokëdhima) nuk mori pjesë në mbledhjet periodike të sekretariatit, kryesisht për shkak të mungesës së ftesës/lajmërimit zyrtar ose për shkak të kritikave të tij ndaj drejtimit politik të PS.

- PS zhvillon rregullisht mbledhje të grupit parlamentar ku diskutohen qëndrimet politike të javës, dhe probleme të tjera të funksionimit. Gjatë muajve të fundit ka pasur disa raste kur zërat kritikë në grup janë ankuar për presion dhe refuzim të së drejtave të tyre të fjalës. Megjithatë mbledhjet e grupit kanë luajtur rol thelbësor në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe gjetjen e akordit politik, sidomos në rastin e votimit të ligjeve të rëndësishme që kërkojnë vendimmarrje politike. Në këtë drejtim, më shumë ndikim kanë pasur mbledhjet e grupit sesa mbledhjet e kryesisë, një raport që bie ndesh me klauzolat statusore. Për tu theksuar është edhe fakti se PS vijon traditën, - mbledhjet e grupit de facto drejtohen nga kryetari i partisë dhe jo kryetari i grupit parlamentar.
- Përgjatë 2016 në PS nuk ka zgjedhje dhe struktura të rregullta funksionale për organizatat partnere, dhe se propozimi i Forumit të Grave në PS për të rritur kuotat e përfaqësimit parlamentar 2017 nga 30% në 50% të listave të kandidimit përbën lajmin dhe risinë e vetme. Gjithsesi në dhjetor Forumi i Gruas në PS, u bë i pari forum i grave që lajmëroi votimin përmes parimit 1 anëtarë – 1 votë. Procesi nuk u ndoq nga media apo grupe vazhdimi, ndaj burim referimi merren të dhënat zyrtare të organizatës. Sipas saj, në zgjedhje morën pjesë rreth 75% e 30 mijë anëtarëve të kësaj organizate, të cilët konfirmuan me votë kryetaren Xhaçka edhe për një mandat tjetër si dhe zgjedhën delegatët për në Konventën Kombëtare.

BILANCI DISIPLINOR DHE PAMUNDËSIA E KRITIKËS NË PS

Dokumentet statusore të PS e lejojnë kritikën dhe ofrojnë garanci për mendimet alternative në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Praktika e debateve në Kongresin e PS (2016), pavarësisht vendimmarrjes, në thelb ishte mbështetëse e këtij argumenti. Kritikët ndaj vijës zyrtare të drejtuesve në PS nuk u përjashtuan, por siç treguan zgjedhjet në organet e reja drejtuese, ata u mënjanuan nga kandidimi dhe shanset për tu zgjedhur.

- Ish Presidenti Rexhep Mejdani, dy herë kandidat për kryetar në PS dhe drejtues i Këshillit të Urtëve më 2013, u mënjanua tërësisht nga PS, madje disa herë pati distancim prej tij, pikërisht për shkak të kritikave të tij adresuar disa vendimeve në PS ose disa zyrtarëve ekzekutivë të saj. Me statusin e PS ish Presidenti mbetet anëtar i përrjetshëm i Asamblesë, gjithsesi Meidani asnjëherë nuk mori pjesë në asamble dhe as kjo e fundit nuk i dërgoi atij ftesë pjesëmarrjeje.
- Gjatë 2016 zërat më të rëndësishme kritike me gjendjen në PS u bënë deputetët Ben Blushi dhe Mimoza Hafizi. Sidomos në prag të Kongresit dhe në fazën pas tij kritikave të tyre u bënë gjithnjë e më sistematike dhe direkte. PS refuzoi mundësinë që mendimet e tyre kritike të diskutohen në struktura dhe të propozimet e tyre të votohen. Përkundrazi. Në të gjitha rastet e deklarimeve mbi këto kritika, kryetari i PS dhe bashkëpunëtorët e tij të afërt, treguan mospërfillje dhe nota denigruese ndaj deputetëve kritikë. Ata nënkuptuan se mirëprisnin largimin e tyre.
- Në nëntor 2016 dy deputetët shpallën ndarjen nga PS dhe nismën për krijimin e një partie të re politike, LIBRA. Ndarja u shoqërua me akuza të ashpra midis kolegëve të dikurshëm dhe nxorën në pah brishtësinë e konceptit të demokracisë së



brendshme dhe konkurrencës së ideve në partitë politike shqiptare. Në disa raste, në adresë të dy deputetëve u investuan edhe zyrtarë të lartë ekzekutiv, të cilët me ligj nuk janë anëtarë të partive dhe mbi bazën e ligjit, do të duhej të mbanin qëndrim asnjës ose në rast angazhimi politik, do të duhej të dorëhiqen nga posti. Asnjë nuk ndodhi, përkundrazi, distancimi denigruet ndaj dy deputetëve rebelë u shndërru në normë komunikimi në PS, dhe nga ana tjetër, edhe retorika kritike e dy deputetëve ndaj PS mori nota maksimale.

- Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese (maj 2016) për heqjen e mandatit të deputetit K.Kokëdhima, njëherësh edhe Sekretar për Reformën Strukturore dhe Emigracionin në PS, raportet e tij me PS ndryshuan tërësisht. Nga njëra anë ai i mënjana nga angazhimi partiak, nuk u ftua në mbledhje dhe aktivitete, nga ana tjetër vetë sekretari Kokëdhima shprehu publikisht kritika ndaj aspekteve të ndryshme të zhvillimeve në PS dhe qeverisjen e vendit. Ai shpalli në nëntor nismën e tij për një lëvizje demokratike brenda PS, me qëllim rritjen e demokracisë brenda saj dhe duke promovuar parimin e zgjedhjes së kandidatëve të ardhshëm për deputet me sistemin e primareve në bazën e partisë.
- Në dhjetor 2016 Asambleja e PS me propozim të kryesisë votoi shkarkimin e z. Kokëdhima nga posti i sekretarit dhe njoftoi largimin e tij edhe nga anëtarësia në Asamble. Argument u përdor retorika e tij kritike ndaj vijës zyrtare politike të PS. Koncepti i “vijës zyrtare” është i paqartë për sa kohë nuk ka qëndrime politike të diskutuara dhe të votuara nga shumica në parti. Gjithsesi, dy detaje janë domethënëse: e para, pavarësisht se vetë Kokëdhima dha dorëheqje nga posti përpara votimit për shkarkim përsëri u vijua me procedurën e paralajmëruar me votim të hapur; dhe e dyta, pas zgjedhjes së ish deputetit në Asamble nuk ka pasur akt kritik nga kryesia apo struktura e garancive statusore në PS, ndaj edhe nuk ka pasur asnjë akt gjykimi, verifikimi apo vendimmarrjeve që provonte papërputhshmërinë midis kandidimit dhe mandatit parlamentar. Shkarkimi i tij në dhjetor u më në formë demonstrative, por më shumë se për arsye parimore, u ndikua nga prishja e raportit personal politik midis kryetarit dhe kritikut të tij si dhe si një mesazh paralajmëruar për individët e tjerë kritikë të mundshëm në parti.
- Pas shkarkimit ish deputeti dhe ish sekretari Kokëdhima ka paralajmëruar ndjekjen e rrugës ligjore për mandatin e tij në Asamble, - duke paralajmëruar të jetë rasti i parë kur një individ në një parti politike i kërkon të drejtat e tij përmes ankimit në sistemin gjyqësor. Gjithashtu ai ka vijuar takime me grupe të ndryshme në bazë, duke promovuar parimin e vendimmarrjeve përmes demokracisë direkte në Partinë Socialiste.
- Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe raste të tjera të raporteve jo institucionale brenda PS, sidomos në lidhje me grupin parlamentar. Për shembull, një deputet, V.Kosta njoftoi në media në korrik largimin nga PS dhe renditi për këtë një numër akuzash për korrupsion dhe mungesë sistemi vlerash. Në dhjetor 2016 ai vijon të jetë ende anëtar i grupit të PS, megjithëse hera herës shfaq kritika publike. Po ashtu, një deputet tjetër, E.Ndocaj lajmëroi në nëntor krijimin e një partie të re politike megjithëse është deputet i PS. Më 2013 ai ishte një nga biznesmenët e afruar në PS, më 2014 ai u bë kritik i ashpër i PS dhe drejtuesve të saj, më 2015 mori mandat parlamentar për shkak të mandatit proporcional në zonën e tij, por vazhdimisht pati mosmarrëveshje me degën lokale të PS dhe në disa raste, edhe mospërputhje me votën politike të PS në parlament.
- Gjithashtu, në kuadër të dekriminalizimit PS u prek gjatë 2016 në dy raste, të cilat përfshijnë deputetët T.Doshi dhe A.Prenga. Deri në dhjetor 2016 nuk ka një vendim gjykate për fajësinë/pafajësinë e tyre, por PS në dy rastet deklaroi publikisht distancimin e saj politik nga dy deputetët. Në fakt, ngjarjet pasuese treguan se nuk pati një akt zyrtar distancimi dhe të dy deputetët ishin pjesë aktive e PS në të gjitha vendimet e rëndësishme, sidomos në votimet politike në parlament. Zyrtarisht ata vijnë të jenë pjesë e PS dhe me ndikim të rëndësishëm në zonat e tyre elektorale. Ashtu si në këto raste, edhe në raste të tjera periferike, (rasti i ish kryetarit të bashkisë Dibër apo një drejtuesi lokal në Sarandë e Peqin, si dhe disa raste të drejtuesve lokalë socialistë), ku zyrtarët e PS janë përfshirë në skandale publike apo akuza penale, nuk është aplikuar një standard sjelljeve e vendimmarrjeje i PS. Kryetari i bashkisë Kavajë, i cili kaloi disa muaj në arrest shtëpiak dhe më pas u shkarkua nga Këshilli i Ministrave pas kërkesës së Prokurorisë dhe KQZ, ende figuron figurë

drejtuese politike në PS dhe ndaj tij nuk është proceduar me asnjë masë disiplinore. Rasti i tij apo edhe të disa drejtuesve të tjerë lokalë, treguan se PS jo vetëm nuk pati distancim publik, por edhe i mbështeti ata përmes strukturës partiake dhe shtetërore, - akte që bien ndesh me frymën e ligjit të dekriminalizimit dhe me një numër rregulloresh etike të miratuara në PS.

DBP NË PS, AKTUALITETI DHE SFIDAT 2017

PS është shquar gjatë tranzicionit si një nga partitë më me shumë demokraci të brendshme, me votime konkurruese, me debate të brendshme dhe me sjellje liberale ndaj grupeve kritike. Gjatë 5-7 viteve të fundit, falë edhe sistemit zgjedhor me lista të mbyllura dhe pushtetit kushtetues të kryeministrit, PS është vet-zhvendosur drejt një partie tradicionale me theks piramidale organizimi. Asnjë prej akteve të saj statusore, rregulloreve, votimeve të brendshme, propozimeve kritike apo debateve politike nuk gjendet në ëedsite-in e saj zyrtar, dhe as në memorien publike të kësaj partie, të paktën gjatë 3-4 viteve të fundit.

- Referendumi 2016 vetëm sa përforcoi natyrën piramidale të drejtimit të saj, si dhe krijimi i një partie të re politike nga dy deputetë vetëm sa e dëshmoi trendin e mungesës së demokracisë së brendshme në këtë parti. Aktualisht në PS bashkëjetojnë dy sisteme funksionimi, - një sistem liberal i shprehjes së qëndrimeve dhe mendimeve, ndryshe nga shumë parti të tjera politike, por edhe një sistem arrogant e refuzues ndaj kritikëve dhe pretendimeve për shkelje të rregullave të brendshme të vendimmarrjes politike.
- Dy sistemet mbivendosen dhe përdoren në varësi nga nevojat e liderit politik, ndaj në thelb nuk janë garanci e standardeve të mira të organizimit dhe funksionimit. Për shembull, ka kërkesa për verifikim votimi, të listës së anëtarësisë apo të vendimmarrjeve, - dhe kjo është pozitive, - por secila prej tyre është refuzuar me arrogancë, dhe kjo është dukshëm negative. Struktura statusore që do duhej të ishte garant e procesit, Komisioni i Garancive Statusore, nuk është funksionale, është jashtë mandatit kohor, si dhe e kompromentuar për shkak të emërimeve të anëtarëve të saj në funksione varësie nga kryetari i partisë, njëherësh kryeministër.
- Gjatë vitit 2017 ky trend pritet të zgjerohet akoma më shumë. Nëse PS nuk arrin të administrojë zërat kritikë dhe të ofrojë zgjidhje statusore për votimin e çdo propozimi të arsyeshëm, ajo rrezikon të fragmentarizohet me ikje të tjera, si dhe të dalë nga zgjedhjet e qershorit 2017 me një strukturë shumë më piramidale sesa aktualisht. Emra të njohur të historisë së saj, aktualisht në parlament dhe në PS, do të kenë shanse minimale për të mbetur pjesë e listës së kandidimit në zgjedhje, ndërkohë që në spektrin e majtë edhe parti të tjera, përfshirë PAA, janë duke tërhequr ish figura përfaqësuese të PS, kritike ndaj linjës aktuale zyrtare.
- Në thelb, PS mbetet një parti e modelit të ri, një parti elektorale që organizohet vetëm në periudhë fushatash, si dhe një grupim politik rreth një programi/oferte, rreth liderit politik të saj, me një demokraci të brendshme jofunksionale dhe me një strukturë vendimmarrëse larg modelit të partive me natyrë institucionale.

■ RAPORT MBI DEMOKRACINË E BRENDSHME NË PD

Gjatë vitit 2016 Partia Demokratike (PD) nuk ka pasur procese të rëndësishme zgjedhore në strukturën e lartë drejtuese. Zhvillimi më i rëndësishëm në aspektin organizativ për PD ishte procesi i brendshëm zgjedhor, në kuadër të ristrukturimit.

- Gjatë 2016 PD nuk ka zhvilluar Kuvend Kombëtar (nuk është periudha statusore e zhvillimit të tij), nuk ka zhvilluar mbledhje të Këshillit Kombëtar (duhej të mbledhesh, të paktën 1 herë) dhe as mbledhje të rregullta të kryesisë (janë zhvilluar vetëm dy mbledhje). Detyrimet statusore nuk janë përmbushur në afate dhe terma konkretë, as në mënyrën e funksionimit të kryesisë, shtesat përmes kooptimeve të vazhdueshme, ndryshimet në departamente, ose edhe ecurinë e proceseve zgjedhore në disa degë si dhe në organizatat partnere, LDG dhe FRPD.
- Strukturat paralele, kryesia-departamentet-koordinatorët nuk kanë arritur ende të funksionojnë në formë statusore, me mbledhje periodike të rregullta dhe me akte transparente pune, - një praktikë që rezultoi pozitiv në aspektin sasior të personave të angazhuar dhe negativ në aspektin cilësor të opozitës institucionale.
- Nga fillimi i vitit 2016 PD bëri një rishpërndarje të angazhimeve të figurave drejtuese nëpër rrethe. Konkretisht, Ristani në Shkodër, Noka në Vlorë, Gjana në Lezhë, Paloka në Tiranë, Imami në Durrës, Shehu në Kukës, Strazimiri në Dibër, Pollo në Fier, Spaho në Elbasan, Ruli në Korçë, Bode në Berat, Shehu në Gjirokastrë, etj. Pjesa më e madhe e drejtuesve u emëruan në krye të qarqeve për herë të parë, disa zëra kritikë u mënjantuan nga drejtimi i qarqeve dhe se procesi nuk gjeti mbështetje të gjerë në degët përkatëse. Përkundrazi, një numër incidentesh dhe akuzash dominuan këtë fazë, gjë që çoi në vendimin tjetër për ri-organizim të shumicës së strukturës lokale.

RIORGANIZIMI NË 35 DEGË, NJË MISION I PAMUNDUR?

- Partia Demokratike, me vendim të kryesisë (28 prill 2016) dhe urdhër të kryetarit (29 prill 2016) shpalli fushatën për riorganizimin dhe plotësimin e strukturave të kësaj partie në degë, grupseksione dhe seksione. Afati i jetësimit të këtij vendimi është data 30 qershor 2016. Vendimi u arsyetua me nevojën për *“përshatjen organizative të PD në nivele qendrore me realitetet e reja si dhe nevojës për të energjizuar veprimtarinë e PD përballë sfidave të ardhshme”*. Drejtuesit e degëve lokale të PD u zgjodhën më 2014 dhe se mandati i tyre statusori është 4 vjet (deri më 2018), megjithatë vendimi i kryesisë (prill 2016) solli ndërprerjen e mandatit për më shumë se një të tretën e drejtuesve të degëve. Konkretisht, u vendos shtimi i 14 degëve të reja, duke rritur numrin e degëve në 67. Rritja e numrit të degëve sjell ndryshime në 35 degë dhe rritjen edhe të numrit të kooptuar të anëtarëve në Këshillin Kombëtar. Në 35 degët ku do të mbahen zgjedhjet e reja, bëjnë pjesë edhe degë ku u shënuan rezultate pozitive në zgjedhjet e fundit lokale (p.sh, Pogradeci), si dhe një numër degësh ku rezultatet lokale kanë qenë negative.
- Vendimi solli reagime kritike nga një numër degësh, të cilat kaluan në zgjedhje të reja. Sipas statutit (neni 4) PD organizohet mbi *“bazën e ndarjes territoriale të vendit”* dhe se me vendim të kryesisë mund të formohen vetëm struktura organizative mbi baza social-profesionale. Në rastin konkret ndarje të tilla, si p.sh, dy degë për bashkinë Durrës, përbëjnë devijim nga ky nen statusor. Për rrjedhojë, kryetari i degës Pogradec, kryetari i degës 3 në Tiranë dhe disa drejtues të tjerë vendorë paraqitën dorëheqje publike në shenjë proteste ndaj këtij vendimi. Pjesa më e madhe e degëve në riorganizim, si dhe disa deputetë të PD-së, sidomos drejtuesit e degëve Vlorë, Durrës, Malësi e Madhe, Pogradec, Dibër, etj, e kritikuan vendimin, duke thënë se ai është jo-statutor², dhe se kompetenca e këtij vendimi

² Një numër kryetarësh të degëve lokale reagues publikisht ndaj vendimit të kryesisë. Duke cituar njërin prej tyre (M. M. PD Vlorë *“vendimi i Kryesisë së Partisë Demokratike është anti-statutor. Nuk janë zbatuar kriteret, nuk ka standarde, është i pamotivuar, i pa-konsultuar me degën, për më tepër duket sikur është një dënim kolektiv pa gjyq i gjithë demokratëve në degët që janë përcaktuar dhe përfshirë në riorganizim”*). Reagim publik kritik pati edhe kryetari i degës Durrës, i degës Pogradec, i degës Malësi e Madhe, i degës Peshkopi, i njësishë 3 në Tiranë, etj, dy prej të cilëve në shenjë proteste dhanë dorëheqje. Kryetarët kritikë ndaj vendimit të kryesisë e konsumuan publikisht shqetësimin e tyre pasi nuk iu mundësua takimi zyrtar me drejtuesit e lartë në PD për të debatuar dhe zgjidhur mosmarrëveshjet.

i përket Këshillit Kombëtar. Projekti bazohej në ndarjen e re territoriale dhe nevojën e përshtatjes së organizimit lokal me kufijtë e ri administrativë. Disa devijime u bënë në raport me ndarjen territoriale, kryesisht për nevoja të brendshme organizimi, sidomos në qytetet e periferisë në jug dhe në veri.

- Në përfundim të afatit kohor monitorimi konstatoi se zgjedhjet e rregullta përfunduan në vetëm 1/3 e degëve të programuara. Në dy të tretat e degëve zgjedhjet u shtynë dhe në 1/3 nuk janë zhvilluar ende (dhjetor 2016). Në disa prej këtyre të fundit po aplikohet praktika e emërimit të drejtuesit lokal (p.sh, Durrës), deri në një vendim të dytë, pas rreth 7 muajsh pa drejtim, u arrit të zgjidhen drejtuesit e degëve Vlorë apo Pogradec, kurse në disa degë të tjera rëndësishme si Tirana, Dibra, etj, ende nuk ka vendimmarrje përfundimtare. Tirana mbetet pa një strukturë unike drejtuese, ndryshe nga parimi i degëve sipas bashkive, dhe ndryshe nga të gjitha partitë e tjera politike konkurruese.
- Gjatë procesit të zgjedhjeve në parti (degët në zgjedhje) u konstatuan problematika të shumta organizative dhe teknike, - mospërputhje midis pritshmërive nga qendra dhe reagimit nga baza e partisë, ikje drejt partive të tjera politike, si dhe shpesh edhe degradim të debatit të brendshëm në grindje, ndarje në grupacione dhe akuza publike në media. U shënuan raste kur kryetari i PD në shenjë proteste kaloi në parti tjetër politike, u tërhoq tërësisht nga politika, apo deklaroi qëndrim publik kritik ndaj vendimeve politike të PD. Rasti i fundit i zgjedhjeve në Dibër, ku PD hyri pa kryesi e kryetar legjitim në degën lokale (për shkak se struktura e vjetër është shkarkuar në prill), tregon një situatë jonormale organizative, dhe siç u pa në praktikë, me potencial për krizë e ndarje të brendshme.
- Pamundësia e zgjedhjeve dhe shtyrja reale e tyre fillimisht për në shtator, më pas për një fazë tjetër, (pa pasur një akt të shkruar zyrtar vendimmarrës nga kryesia që shtyn procesin), pamundësoi edhe mbledhjen e rregullt të Këshillit Kombëtar, strukturë, e cila sipas Statusit të PD, do të duhej të konsultohej për vendime të rëndësishme politike midis dy Kuvendeve. Në nëntor PD bëri mbledhjen e parë të kryetarëve të degëve, përfshirë me kryetarët e zgjedhur dhe ata të emëruar, me synim zgjerimin e anëtarësisë dhe përgatitjet për aksionin politik 2017 dhe për zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

VENDIMMARRJA VERTIKALE, TIPAR DOMINUES NË PD

- Në nëntor kryetari i PD langoi nismën e tij për hapjen e partisë me prurje të reja, kryesisht individë që janë mënjeluar, përjashtuar apo kritikuar nga strukturat tradicionale lokale e qendrore, si dhe premtoi aplikimin e votës së anëtarësisë në përzgjedhjen e kandidatëve për deputetë më 2017. Deri në janar të këtij viti procesi i hapjes nuk ka dhënë rezultate konkrete, kryesisht edhe për shkak të natyrës së mbyllur organizative që dominon aktualisht në strukturat qendrore e lokale të PD. Nëse premtimi i tij realizohet lidhur me deputetët, kjo do të jetë hera e parë që sistemi i primareve përdoret në një parti politike. Fakti se PD nuk ka struktura lokale solide dhe se nuk ka një regjistër kombëtar të anëtarësisë, flet për pamundësi votimi në bazë, gjithsesi pranvera e vitit 2017 do të jetë rasti i parë i testimit të këtij premtimi.
- Gjatë procesit të reformës në drejtësi (korrik 2016) PD nuk e mblodhi Këshillin Kombëtar dhe as kryesinë, dhe shumica e vendimeve u mor ose përmes mbledhjes së grupit parlamentar, një strukturë e cila nuk e ka këtë tagër në përcaktimet statusore, por që mbetet organi më i rëndësishëm ekzekutiv dhe politik në PD. Në aktivitetin javor PD i ka dhënë prioritet mbledhjeve të rregullta të grupit parlamentar, grup i cili sipas statusit, nuk mund të jetë vendimmarrës lidhur me politika identitare dhe parimore të partisë, por është zbatues i tyre. Disa nga deputetët anëtarë të grupit nuk janë njëherësh edhe figura partiake me përvojë dhe as me karrierë të mëparshme. Praktika e forcimit të mbledhjes së grupit mbetet trend për partitë shqiptare, përfshirë PD, pavarësisht se kryetari i partisë nuk është deputet dhe se mbledhjet e grupit pothuajse asnjëherë nuk janë drejtuar nga kryetari i grupit parlamentar.

- Kryetari i PD i ka propozuar kryesisë propozimin për kuotën 35% e të rinjve në listën e ardhshme zgjedhore. Koncepti i përqindjes së kuotës rinore lidhet me tendencën e reformimit edhe moshor të grupit përfaqësues parlamentar, por ka ndeshur në kritika e pakënaqësi nga pjesa tradicionale e partisë, disa prej të cilëve kanë shprehur kritika publike dhe nuk janë mbështetës i kuotave të paracaktuara.
- Kryesia e PD vendosi (28 prill) gjithashtu ngritjen e degës së saj në Londër (Angli) në kuadër të zgjerimit të saj me degë në emigracion. Dega në Londër përbën rastin e parë kur një parti shqiptare krijon strukturë politike përfaqësuese në Britaninë e Madhe. Më parë, PS, PD, LSI, etj, kanë krijuar degë të partive respektive në Greqi, Itali, Gjermani, etj. Bazuar në nenin 37, pika 2 (c) Këshilli Kombëtar ka kompetencë të ndërmarre të gjithë dispozitivin e nevojshëm për zbatimin e Statutit dhe për mbarëvajtjen e partisë. Caktimi i një dege të re apo ri-organizimi tërësor i strukturës së degëve është përgjegjësi e Këshillit Kombëtar, jo e kryesisë në PD.
- Sipas nenit 37, pika 2 (b/v) përcakton se Këshilli Kombëtar zgjedh me votim të fshehtë drejtuesit e departamenteve. Sipas nenit 43/1 të Statutit të PD drejtuesit e departamenteve “zgjidhen me propozim të Kryetarit nga Këshilli Kombëtar”. Megjithatë, ndryshe nga ky rregull, në mbledhjen e kryesisë në prill 2016 PD vendosi emërimin e 6 (gjashtë) drejtuesve të rinj në krye të departamenteve³. Emërimi i tyre u bë pa konkurrim dhe votim të fshehtë. E njëjta praktikë u aplikua më parë edhe në disa shtesa të tjera në kryesi, përfshirë tre kryetarë të rinj të bashkive, kryetarit të Bordit të FLD, si dhe Kryetarit të Komisionit për Etikë e Integritet. Më vonë edhe dy anëtarë të tjerë u caktuan përmes emërimit direkt, duke rritur numrin e kryesisë. Sipas nenit 39 pika 3, drejtuesit e departamenteve janë automatikisht edhe anëtarë të Kryesisë së PD-së, ndaj edhe shtimi i anëtarëve të kryesisë nga vetë kryesia, pa votim në strukturën statusore të Këshillit Kombëtar dëmton parimin e zgjedhjes dhe të ndarjes/balancës së strukturave vendimmarrëse.
- Në debatet në grup vazhdimisht janë shfaqur zëra kritik parlamentar ndaj vijës zyrtare politike të kryetarit të PD, përfshirë edhe ndjekjen e praktikave jo statusore të vendimmarrjes (Selami, Topalli, Bregu, Patozi etj). Kritikën e tyre në përgjithësi nuk janë marrë në konsideratë dhe as janë votuar, përkundrazi. Debatet e brendshme në grup dhe zërat kritik për votën pro reformës shkaktuan paralajmërime për përjashtime nga PD, një masë e cila gjithashtu nuk është statusore. Mbi deputetët që vunë në diskutim linjën zyrtare në PD në nivele të dyta vendimmarrëse pati kërcënime publike për mos-kandidim në zgjedhjet e radhës, pati sulme denigruese në media e rrjete sociale, nuk pati debat të brendshëm mbi tezat dhe propozimet e tyre përmirësuese, si dhe ata prej atëherë ende nuk janë ftuar në asnjë aktivitet publik të partisë. Në fund të procesit askush nuk u përjashtua por doli dukshëm në pah nevoja e madhe që kjo parti ka për hapje ndaj mendimeve kritike e liberale brenda saj. Aktualisht në parti nuk ekzistojnë mekanizma funksionale që garantojnë trajtimin e pretendimeve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Komisioni Qendror për Apelimin dhe struktura të tjera gjyqësore mbeten ende jo funksionale.
- Në dy zgjedhjet e pjesshme të zhvilluara, ato në Dibër dhe në Kolonjë, PD aplikoi formën klasike të imponimit të kandidatit nga qendra, ndryshe nga propozimi i bazës dhe degës lokale partiake. Në rastin e Dibrës PD kandidoi një deputet, një figurë qendrore politike, duke refuzuar listën e kandidatëve të ardhur nga dega lokale, gjë që solli reagim nga baza, përfshirë kryetari lokal në detyrë. Në Kolonjë nuk pati reagim kryesisht për shkak të shanseve minimale për fitore, por vendimi për kalimin e kandidaturës për një parti të tretë politike nuk kaloi përmes vendimmarrjes së kryesisë lokale dhe as qendrore.
- Në kriteret zgjedhore në degët e partisë dhe në strukturat e tjera vendimmarrëse dhe përfaqësuese politike PD ka përfshirë edhe detyrimet që burojnë nga ligji i de-kriminalizimit. Në funksion të arritjes së këtij qëllimi PD krijoi e para një strukturë të posaçme shqyrtimi, Komisionin për Etikë dhe Integritet. Megjithatë risi pozitive, ky komision nuk është mbledhur asnjëherë, nuk ka strukturë funksionale, nuk ka rregullore dhe për rrjedhojë nuk ka mekanizma të jetë funksional as

³ U bë emërimi i E. Alibeaj kryetar i Departamentit të Sigurisë dhe Rendit Publik, A. Turku, kryetar i Departamentit të Pushtetit Vendor, G. Malko kryetar të Departamentit të Pronave, T. Alizotaj kryetar të Departamentit të të Përndjekurve Politikë, E. Çeno kryetar i Departamentit të të Drejtave të Njeriut, si dhe E. Saliqit sekretar i Aksionit Qytetar.

në praktikën shqyrtuese të kandidatëve që do të zgjidhen në krye të 35 degëve, siç nuk u përfshi në praktikën shqyrtuese për kooptimet e reja në Kryesi dhe në krye të departamenteve.

- Në nëntor 2016 gjatë një seance në Kuvend për të votuar një prej ligjeve që lidhen me reformën në drejtësi, grupi parlamentar i PD bojkotoi seancën. Një deputet, M.Fufi, qëndroi në votim dhe e mbështeti ligjin. Të nesërmen PD njoftoi zyrtarisht përjashtimin e tij nga grupi parlamentar dhe njëherësh edhe nga partia. Vetë deputeti tha se nuk ka marrë njoftim zyrtar dhe nuk ka pasur mbledhje të ndonjë strukture partiake për një vendim të tillë. Në të vertetë nuk pati as mbledhje grupi, as votim dhe as vendimmarrje të kryesisë. Përjashtimi i Fufit është një rast unik në këtë legjislaturë, dhe një akt që pritej në kuadër të angazhimeve të PD për standarde etike dhe procesit të dekriminalizimit, por forma, preteksti dhe momenti i gjetur për përjashtimin nxorri në pah natyrën jointitucionale dhe jo transparente të vendimmarrjeve në PD.
- Në dhjetor KQZ, me kërkesë të prokurorisë, i hoqi mandatin parlamentar deputetit D.Tahiri, anëtar i grupit parlamentar të PD. Vendimi ishte pjesë e tri akteve të njëjta që preknin tri partitë kryesore politike. Si në dy partitë e tjera, edhe në PD, heqja e mandatit nuk u shoqërua me masë politike distancimi, pezullim të funksioneve lokale në parti ose anëtarësisë në grup parlamentar. Zyrtarisht PD nuk mbajti qëndrim, kurse përfaqësuesit e saj në KQZ votuan kundër heqjes së mandatit të tij.


DBP NË PD, AKTUALITETI DHE SFIDAT 2017

- PD ka paralajmëruar ndryshime të rëndësishme strukturore në prag të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Ajo synon të përsërisë praktikën e KOP, një strukturë e krijuar me prurje të jashtme nga shoqëria civile, e cila funksionoi më 2005. Për ta arritur këtë PD duhet të ndryshojë shumë në imazhin, përbërjen, drejtimin politik dhe sjelljen e saj politike, - një mision gati i pamundur për një kohë kaq të shkurtër.
- Strukturat vendimmarrëse në PD priten të mos jenë funksionale edhe në muajt e ardhshëm. Mbledhja e tyre sjell më shumë kritika për inaktivitetin e deritanishëm dhe riciklon figurat e vjetra politike në bazë dhe në qendër, ndaj stafi i ri drejtues në PD nuk preferon të veprojë përmes strukturave klasike. Ata mbështeten tek departamentet dhe koordinatorët, funksione të emëruara nga kryetari dhe që përbëjnë rrethin e bashkëpunëtorëve të afërt.
- Gjatë fillimit të vitit 2017 një problematikë serioze do të jetë sprovat me të cilën PD do të përballojë debatet e brendshme në grupin parlamentar dhe në degët kryesore lokale. Të gjithë kryetarët lokalë pretendojnë kandidimin në listën shumë-emërore për deputet, një kërkesë që e cila nënkupton edhe postimin nga lista të shumë prej figurave aktuale përfaqësuese, të cilat gjithashtu kanë ambicie të qarta rikandidimi në zgjedhje.
- Strukturat e garancisë, siç janë komisioni disiplinor dhe komisionet etike, etj, nuk kanë zhvilluar asnjë mbledhje dhe nuk priten të kenë mbledhje të tilla as në periudhën e mbetur deri në zgjedhje. Në çdo analizë, rendja për korrektesës statusore në PD konsiderohet e tepërt përballë nevojës së saj për aksion politik permanent dhe përgjigje ndaj nismave të ndryshme politike që vijnë nga qeveria.
- Premtimi i kryetarit të PD për hapjen e partisë, prurje të reja, konkurrencë dhe zgjedhje të organeve të reja përfaqësuese parlamentare përmes votimit në bazë, përbëjnë sprovën kryesore në asketin e demokracisë së brendshme në këtë parti. Një aspekt tjetër test për organizimin dhe fuqinë reaguese të saj, mbetet edhe aftësia për të krijuar një koalicion sa më të gjerë dhe efikas me parti të tjera politike të spektrit politik dhe me grupe civile.

■ DBP NË LËVIZJEN SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)

Lëvizja Socialiste për Integrim ka zhvilluar zgjedhje për kryetarin e saj dhe për një sërë strukturash dytësore gjatë vitit 2016. Gjithsesi, LSI nuk ka pasur sprovë të rëndësishme të vlerësimit të demokracisë së brendshme. Duke funksionuar si një parti me bazë të kufizuar përfaqësimi dhe me liderin themelues në krye të saj, pritshmëritë për zhvillime intensive të brendshme mbeten jo reale.

- Në nëntor 2016 LSI zhvilloi zgjedhjet e radhës për postin e kryetarit. Zgjedhjet e fundit datonin më 2012, ndaj sipas statusit, pas 4 vitesh do të duhej të zgjidhej kryetari i radhës. Në funksion të këtyre zgjedhjeve LSI u përpoq të zhvillonte një fushatë më shumë sensibilizimi sesa konkurrimi në parti. Për rreth 30 ditë LSI prezantoi tre kandidatë për kryetar, kryetarin themelues Ilir Meta, ish rektorin e UT Shezai Rrokaj si dhe deputetin Përparim Spahiu. Tre kandidatët zhvilluan disa aktivitete lokale, në shumicën e rasteve me dalje të përbashkët përpara anëtarësisë dhe me diferenca formale midis platformës së secilit prej tyre. Dy kandidatët sfidues nuk shprehën asnjë vërejtje për kryetarin Meta, pra kandidatin e tretë, ndaj edhe më shumë se garë për kryetar procesi i votimit në LSI përbën një test për mobilizimin dhe evidentimin e strukturave në prag të zgjedhjeve parlamentare 2017.
- Referimi burimeve zyrtare të LSI në votime morën pjesë 84.23% e anëtarëve me të drejtë vote, rreth 7930 nuk morën pjesë. Më 2012 LSI deklaroi 31 000 anëtarë, më 2016 ajo deklaroi 50300 anëtarë. Nga kandidatët, Meta u rikonfirmua me 76% të votave, ose 31.815 vota. Pas tij Spahiu fitoi 5605 vota ose 12.1% të votave, dhe Rrokaj mori 4982 vota ose 11.9% të votave. Të dhënat e qarqeve dëshmojnë se përqindja më e ulët e pjesëmarrjes ishte në Elbasan (70%) dhe Lezhë (77%), kurse më e larta në Fier (89%) si dhe me nga 88% në Berat, Tiranë e Shkodër. Shifrat e larta të pjesëmarrjes nuk u verifikuan nga burime të tjera, për shkak se procesi nuk pati monitorim të jashtëm dhe as mbulim të rregullt nga media. Gjithsesi LSI është parti e njohur për organizim kapilar dhe strukturë solide që lëviz lirshëm në varësi nga orientimi politik i strukturës qendrore.



- Gjatë procesit të zgjedhjeve në LSI pati disa incidente, të cilat nuk u bënë objekt debati dhe as nuk u përmendën në fjalimet/prezantimet e kandidatëve. Rasti më i njohur ishte dorëheqja kolektive e pjesës më të madhe strukturore e kryesisë së LSI Vlorë, dhe lëvizja e kësaj pjese drejt PS. Gjithashtu lëvizje të tilla pati edhe në disa degë të tjera periferike, siç pati edhe prurje të reja kryesisht nga ish anëtarë të PD ose partive aleate të saj.
- Nga tre kandidatët në garë deputeti Spahiu shënon një zhvillim interesant në funksion të demokracisë së brendshme. Në muajin qershor 2016 ai u pezullua nga grupi parlamentar, me një vendim fillimisht të grupit dhe më pas edhe të kryesisë, për shkak të një shënimi kritik të tij në rrjetet sociale në raport me reformën në drejtësi. Sipas dokumenteve statusorë të LSI pezullimi/përrjashtimi ndodh kur ka votë politike kundër, jo kur paralajmërohet votë kundër, pra përpara kryerjes së aktit politik. Më 22 korrik Spahiu votoi pro reformës, ndaj edhe pezullimi u anulua.


dhe një muaj më vonë ai hyri në garën për kryetar. Praktika e pezullimit dhe më pas e anulimit të pezullimit, më shumë sesa produkt i një analize dhe trajtimi të rregullt statusor në LSI ishte një lëvizje politike për tërheqje të vëmendjes. Gjithashtu, edhe ndryshimi në degën Vlorë dhe emërimi i një drejtuesi nga Tirana nuk u bë përmes një vendimi institucional nga kryesia, por kryesisht përmes linjës vertikale në parti.

- LSI zhvilloi në dhjetor një mbledhje të Komitetit Drejtues, ku zhvilloi zgjedhjet e ekipit drejtues. Kryesia shpalli nga një kandidat për post drejtues, por në disa funksione pasi kandidatura të tjera të vetëshpallura, të cilat gjithsesi ishin më shumë akte me natyrë formale sesa konkurrenca reale. LSI zgjodhi zv/kryetarin (P.Vasili), n/kryetarët (L.Rama dhe K.Mehmetaj), Sekretarin e Përgjithshëm (E.Brahimllari), kryetarin e KDK (Sh.Rrojka), si dhe sekretarët (Xhixho, Bixha, Haxhinasto e Shaqiri). Risi e këtyre zgjedhjeve ishte promovimi i figurave rinore në poste të larta partiake (Brahimllari, Mehmetaj dhe Bixha), si dhe emërimi sekretar i njërit prej drejtuesve më jetëgjatë të shërbimit sekretar shqiptar.
- LSI zgjodhi gjithashtu delegatët e saj për një Konventën Kombëtare, si dhe pritjet të mbyllë së shpejti procesin zgjedhor në të gjitha nivelet drejtuese. Vlen të theksohet se LSI bëri disa ndryshime edhe në kabinetin qeveritar, përfshirë zëvendësimin e dy ministrave të saj, - një vendimmarrje edhe kjo kryesisht vertikale dhe pa votim në strukturat përparëse politike.
- Në fillim të muajit mars LSI njoftoi se do të ndërmarrë një fushatë në nivel lokal për ri-organizimin e degëve në përputhje me ndarjen e re administrative, si dhe me rifreskimin e anëtarësisë në parti. Ajo raportoi se në fillimin e muajit mars, përpara reformës në degë, numëronte 40 mijë anëtarë, nga 50 mijë të njoftuar në përfundim të këtij procesi. Rritja kaq e madhe për një parti të vogël politike shpjegohet kryesisht me përqindjen e lartë në pushtetin administrativ e ekzekutiv që LSI ka si dhe interesin e zyrtarëve të përfshirë në këto institucione për të pasur mbështetje politike nga LSI.
- Megjithëse përcaktimi statusor në LSI kërkon mbledhje periodike të rregullta të Komitetit Drejtues, etj, në faqen zyrtare të saj njoftimi i fundit për mbledhjen e KD është i datës 23.11.2015, pra rreth një vit më parë. Gjithashtu mbledhjet e kryesisë nuk janë të rregullta dhe se praktika e konsultimeve të grupit parlamentar janë dominuese mbi strukturat e tjera vendimmarrëse, megjithëse në status hierarkia është e kundërt. Në të dhënat zyrtare online LSI nuk ka publikuar as anëtarët e KDP, koordinatorët dhe as të dhëna zyrtare që lidhen me degët, strukturat e rinisë dhe gruas, si dhe as akte të vendimmarrjeve politike.
- LSI ishte partia e parë që lajmëroi publikimin online të shpenzimeve financiare dhe në faqen e saj zyrtare gjenden disa njoftime të tilla. Praktika e ndjekur prej saj përbën risi pozitive, gjithsesi ende një masë e pa-mjaftueshme për të dëshmuar transparencë reale dhe korrektesë në deklarime dhe burimet e financimit. Një pjesë e faturave financiare deklarohen kontribute vullnetare, ndërkohë që vetëm një pjesë e vogël e aktiviteteve përfshihen në deklarimet online.
- Nga ana dokumentare, LSI nuk ka pasur ndryshime në program dhe as në strukturë, nuk ka ndryshime statusore dhe as miratim rregulloresh të reja. Ndryshime kanë ndodhur në aspektin operacional organizativ, kryesisht për përputhshmëri më të madhe me ndarjen e re territoriale dhe pritshmëritë elektorale 2017. Shumica e dokumenteve të saj politikë në faqen zyrtare online janë të periudhave të hershme (më shumë se dy vjet më parë), dhe se nuk ka pasur përpjekje konkrete prej saj për më shumë transparencë në aktivitetin e strukturave, përbërjen dhe vendimmarrjet e tyre.

■ DBP NË PARTINË DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET (PDIU)

PDIU është partia e katërt më e rëndësishme në parlamentin aktual. Ajo ka pasur vështirësi në orientimin politik, kryesisht për shkak se në zgjedhjet 2013 ishte pjesë e koalicionit politik të djathtë, ndërsa aktualisht është pjesë e koalicionit të majtë në pushtet.

- Për shkak të ndryshimit të pozicionit politik, PDIU ka pasur debate të brendshme dhe lëvizje edhe deputetësh. Konkretisht, deputeti (tashmë i zëvendësuar) Dashmir Tahiri i qarkut Vlorë nuk figuron në grupin parlamentar të PDIU dhe nuk është pjesë e lidërshiptit të saj. Ai është identifikuar me PD dhe aleatët e saj tradicionalë dhe pritet të kandidojë më 2017 për njëren prej partive të saj aleate. Gjithsesi PDIU ka arritur të ruajë përfaqësimin parlamentar edhe për shkak të bashkimit me këtë grup të deputetes së PD, Mesila Doda.
- Një nga tiparet kryesore të partive të vogla politike në parlament është përpjekje për krijim të një grupi parlamentar dhe mbështetja nga partitë e mëdha për këtë qëllim. Për shkak se për një grup parlamentar duhen 7 deputetë, PDIU huazoi formalisht nga PS të paktën 3 deputetë: A.Xhindi, B.Derveni dhe G.Rehovica. nuk ka një vendim politik të kryesisë së PS për kalimin formal të tre deputetëve tek PDIU dhe as një vendim politik të PDIU për pranimin e tyre, siç nuk ka asnjë rast të vetëm kur 8 deputetët (5 nga PDIU dhe 3 nga PS), të jenë mbledhur si grup parlamentar për debat ose vendimmarrje.
- Zhvillimi më i rëndësishëm për PDIU ishte organizimi i procesit të zgjedhjeve për kryetar. Zgjedhjet u zhvilluan me parimin “1 anëtar – 1 votë” me 21 maj 2016, një risi për partitë e vogla politike shqiptare. Në garën formale për kryetar ishte ish kryetari Shpëtim Idrizi dhe një rival formal, Halil Hyseni. Sipas njoftimit zyrtar nga kjo parti, në votimin e anëtarësisë më 21 maj në total votuan 19634, ose 81.5 për qind e 24 mijë anëtarëve. Në përfundim, Idrizi u rikonfirmua kryetar me 14087 vota ose 72.6% të votave, kurse kandidati formal Hyseni mori 5367 vota, ose 27.6 për qind të votave të vlefshme. Mandati i kryetarit është 4 vjet (2016-2020). Në të njëjtën ditë PDIU zhvilloi edhe zgjedhje në kryesitë e degëve, kryetarët dhe për delegatët. Nuk pati njoftime për parregullsi dhe as ankesa, por gjithashtu nuk pati as mekanizma monitorimi të standardeve dhe saktësisë së procesit të votimit dhe administrimit të votës.



- PDIU i forcoi pozitën e saj politike më 2016 me marrjen e postit të zv/kryetarit të Kuvendit dhe rezultatin pozitiv të kësaj partie dhe koalicionit në bashkinë Dibër. Angazhimi i saj në koalicion u pa gjerësisht si përpjekje e PS për të balancuar partneritetin strategjik me LSI. Gjithsesi, edhe pse PDIU luajti rol aktiv në Dibër, drejtuesit kryesorë të kësaj partie nuk ishin pjesë e fushatës elektorale atje. Kjo, për shkak se më shumë sesa sigla partiake, suksesi lokal i dedikohet fushatës personale të individëve që përdorin / përfaqësojnë siglën e PDIU.
- Në tetor 2016 PDIU njoftoi zhfjedhjet plotësuëse në ekipin drejtues. Mesila Doda, ish deputete me dy mandate në PD, u votua me konsensus për sekretare e Përgjithshme. E njëjta praktikë votimi pa kandidatë rivalë u aplikua për zgjedhje e dy nënkryetarëve Halil Hyseni dhe Abaz Hado, si


dhe për zgjedhjen e sekretariatit: sekretar organizativ Alfred Deshati, sekretar i çështjeve zgjedhore Erion Manohasa dhe sekretare për organizatat partnere Alda Hasani.

- Një zhvillim pozitiv nga PDIU është fakti se kjo parti ka krijuar tashmë një faqe online në internet, me të dhëna mbi programin dhe qëndrimet e saj politike. Faqja gjendet në adresën <http://pdiu.al/faqa/>. Faqes i mungojnë të dhëna të rëndësishme, siç janë statusi, të dhënat për kryesinë, strukturat drejtuese partiake, financimin, etj, gjithsesi, në kuadër të rritjes së transparencës ky mbetet një zhvillim pozitiv, dhe një reflektim nga kritikantët e adresuara në raportet paraprake të ISP mbi transparencën publike të PDIU dhe në tërësi, të partive politike.

■ DBP NË PARTIA REPUBLIKANE (PR)

Partia Republikane është një nga partitë e vogla parlamentare me më shumë mbledhje dhe aktivitet institucional.

- Ajo ka zhvilluar të paktën tri mbledhje të Asamblesë Kombëtare gjatë vitit 2016, si dhe disa mbledhje të tjera kryesie, me drejtuesit lokalë, me rininë, me gratë, etj, bilanc që nuk gjendet në pjesën më të madhe të partive të vogla parlamentare dhe jo parlamentare. Gjatë vitit 2016 PR nuk pati procese zgjedhore për kryetar dhe as Kongres Kombëtar.
- Një nga zhvillimet kritike në PR është tkurrja e grupit të saj parlamentar nga 2013. Më 2013 PR fitoi katër deputetë, një përmes listës shumë-emërore të PD dhe tre në votimin e saj brenda koalicionit të djathtë. Menjëherë pas zgjedhjeve një prej deputetëve (L.Luzha) u zhvendos tek LSI. Kohë më pas edhe një tjetër deputet republikan, (Y.Shehu) kaloi me LSI. Më 2016 edhe deputeti i tretë, (A.Duka) pati mosmarrëveshje drejtimi në PR dhe preferoi largimin prej saj duke u bërë kryetar në një parti tjetër politike, Partia Agrare Ambientaliste. Në çdo rast largimet dhe lëvizjet u bënë jashtë strukturave dhe praktikeve të mira të debatit, kryesisht bazuar në axhenda personale.
- PR më 2016 u përpoq të plotësonte stafin drejtues duke ofruar figura të reja. Ajo aktualisht ka caktuar sekretar organizativ Albano Zhapaj, nënkryetare Brunilda Laboviti, Sekretar Edmond Nushi dhe Ingrid Mingomataj, si dhe nënkryetare në Asamble Teuta Kodra. Të dhënat për publikun u bënë të njohura vetëm nga publiket në faqen e re online të PR (<http://prsh.al/>), në të cilën gjenden edhe të dhëna nga programin politik dhe aktivitetin kryesor të kësaj partie. Mungojnë të dhëna për statusin, kryesinë, strukturat e tjera mbështetëse, por gjithsesi, hapja e faqes online dhe përpjekja për ta përditësuar atë me të dhëna cilësore përbën zhvillim me trend pozitiv në aspekt të transparencës.



■ DBP NË PARTINË BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)

PBDNJ nuk ka pasur zhvillime të rëndësishme brenda saj përgjatë 2016.

Në muajin korrik votimi për konfirmimin e kryetarit Vangjel Dule në post edhe për një mandat tjetër ishte formal dhe pa kandidatë rivalë. Çështja më e rëndësishme e Kongresit lidhej me pozicionin politik të kësaj partie, e cila gjatë 2016 kaloi nga mazhoranca në opozitë. Kongresi miratoi edhe draftin e programit të ri politik të PBDNJ, ndryshimet statusore dhe bëri

zgjedhje plotësuese për strukturat drejtuese. Shumica e këtyre të dhënave nuk gjenden në faqen online të PBDNJ (<http://al.pbdnj.com/>), ku gjithsesi gjenden qëndrime politike të PBDNJ, disa njoftime organizative dhe sidomos aktiviteti parlamentar i deputetit të vetëm të kësaj partie, V.Dule.

- Me 3 dhjetor PBDNJ plotësoi ekipin e saj drejtues. Këshilli i Përgjithshëm Drejtues zgjodhi kryesinë e re të PBDNJ, koordinatorët e qarqeve, si dhe ekipin politik mbështetës të kryetarit. Konkretisht, nënkryetarë u zgjodhën pa votë alternative Jorgo Xomaka, Garufo Noti dhe Gjovalin Valca. Të dhënat për votimin dhe përbërjen e kryesisë nuk janë bërë publike.
- Pavarësisht se për një parti të vogël si PBDNJ zhvillimet e brendshme partiake nuk kanë qenë thuajse asnjëherë objekt i debatit publik, duhet thënë se edhe në Kongresin e fundit, një prej nënkryetarëve (TH.P), dha dorëheqje për shkak të preferencave të tjera në lidhje me vendin e PBDNJ në koalicionet politike. Në disa degë të vendit, sidomos në jug, ka pasur rivalitete, kritika, pretendime dhe debate edhe në media në lidhje me politikën drejtuese në PBDNJ dhe çështje të interesit në përfaqësim lokal, por në linjë statusore dhe organizative kryetari Dule e dominon partinë dhe nuk ka pasur fraksione apo problematike të dukshme.

■ DBP NË PARTITË E VOGLA PARLAMENTARE

Në partitë e tjera politike parlamentare (PBKD) ose me përfaqësim indirekt parlamentar si PAA, LZHK, PKD, etj (për shkak të mandateve të fituara në listat shumëemërore të PD), nuk ka pasur zhvillime të rëndësishme dhe as ngjarje me interes publik.

- Në fundin e vitit 2015 PBKD ndryshoi zyrtarisht kryetarin, dhe deputetin, duke zgjedhur në drejtim avokatin Dhimitër Muslia, ish kryetar i kësaj partie më 2013. Gjatë fillimit të vitit 2016 PDK dhe PBKD ranë dakord për shkrirje midis tyre, por procesi i nisur nuk u jetësua deri në fund. PBDK ka një kryesi funksionale, ka kryer një mbledhje të një Aktivi Kombëtar, ka bërë disa ndryshime në stafin drejtues, - të gjitha këto në përpjekje për të pasur një rol më aktiv në jetën politike. PDK (<http://www.pdk.al/>) nga ana e saj, nuk ka zhvilluar Kuvend zgjedhore prej shumë vitesh dhe as gjatë 2016 nuk pati mbledhje kombëtare. Vendimmarrjet e saj bazohen kryesisht në vendimmarrjet e kryesisë ose të stafit drejtues.
- Edhe LZHK ruan të njëjtat cilësi, me dallimin se LZHK (<http://lzhk.al/>) nuk ka të dhëna që mund të vertetojnë ekzistencën e strukturave të zgjedhura qendrore ose lokale, dhe as mbledhje të karakterit organizim ose vendimmarrës.
- Në mars 2016 ish ministri i PS Agron Duka, më vonë edhe deputet i PD, u zgjodh kryetar në Partinë Agrare Ambientaliste (PAA). Pavarësisht se zgjedhja ishte pjesë e marrëveshjeve personale midis politikanëve dhe partive simbolike, kalimi i tij në forcën politike agrare/ambientaliste ishte i natyrshëm dhe pati impakt publik. PAA shumë shpejt ndryshoi tërësisht strukturat e saj politike dhe organizative, ofroi politikë të majtë dhe të djathtë, miratoi një program dhe një status, si dhe zhvilloi aktivitete të ndryshme kombëtare e lokale. Në tetor 2016 PAA zhvilloi Konventën Kombëtare, më e madhja e zhvilluar nga ndonjë parti e vogël politike në Shqipëri.
- Në nëntor PAA përfitoi nga mbështetja e dhënë nga PD në kuadër koalicioni, për të kandiduar në Kolonjë me kandidatin e saj për kryera bashkie. Fushata lokale atje, megjithëse nuk rezultoi me sukses, përbën një test të rëndësishëm për këtë parti dhe ishte tregues i forcës së saj në rritje. PAA pritet të ketë një rol konkurrues në zgjedhjet 2017 për vendin e forcës së katërt politike në vend, dhe pas zgjedhjeve, pritet të jetë në qeveri pavarësisht pala kryesore fituese.
- Në dallim nga partitë e tjera të vogla PAA ka faqe aktive interneti me të dhëna mbi partinë, programin, departamentet, drejtuesit lokalë, etj. Të dhënat nuk janë të plota (mungojnë të dhënat e plota për stafin drejtues dhe strukturat lokale, të dhënat mbi financimin ose statusin), por duke qenë parti me aktivitete real vetëm disa mujor, tregon një trend pozitiv të saj në raport me detyrimin ligjor dhe transparencën publike.

■ DBP NË PARTITË E REJA POLITIKE

Gjatë 2016 janë krijuar edhe dy parti të reja politike, SFIDA PËR SHQIPËRINË, e drejtuar nga ish kandidati i pavarur për bashkinë Tiranë (2015) Gjergj Bojaxhiu dhe LIBRA, e drejtuar nga dy deputetët e PS, Ben Blushi dhe Mimoza Hafizi.

- SFIDA u shpall në tetor, kurse LIBRA në nëntor 2016. Dy partitë e reja kanë të njëjtat tipare: janë parti të hapura, premtojnë vendimmarrje nga anëtarësia dhe përdorimin masiv të komunikimeve direkte me anëtarët (edhe përmes rrjeteve sociale), kanë kryesi dhe strukturë drejtuese kolektive dhe kritikojnë modelet organizative dhe funksionale të partive të mëdha, sidomos PS e PD.
- Dy partitë kanë faqe interneti, kanë të publikuara programet dhe statutet, japin të dhëna për aktivitetin e përditshëm dhe mbajnë qëndrime politike për aktualitetin. LISTA provoi të organizojë votim online për buxhetin e shtetit dhe nismën e saj për zgjedhje direkte të Presidentit, - nisma që përbëjnë risi, por që nuk patën ndikim në vendimmarrjet politike në vend.
- Asnjëra nga dy partitë nuk ka zhvilluar ende zgjedhje kombëtare, dhe se ato ndodhën në fazën e shtrirjes në rrethe. Do të duhet të pritët sjellja e tyre ndaj proceseve të brendshme zgjedhore dhe vendimmarrjeve politike në zgjedhjet 2017 për të gjykuar përputhshmërinë midis akteve konkrete dhe normave statusore, si dhe nivelin e demokracisë së brendshme partiake.
- Nga dy partitë, LIBRA (<http://libra.al>) është më aktive në organizim, në prezantime publike dhe me deklarime politike, kjo ndihmuar edhe nga fakti se dy deputetët krijues të saj janë prezentë me diskutimet e tyre politike pothuajse në çdo seancë plenare në Kuvend.

■ DBP NË FRESH: RISI DHE PROBLEME

FRESH (Forum i Rinor Eurosocijalist) është organizata më e madhe të të rinjve të majtë politikë në Shqipëri. Për shkak të historikut aktiv të tij dhe drejtimit nga figura, të cilat gjatë viteve u bënë politikanë drejtues kryesorë në vend, FRESH ka pasur një debat aktiv brenda tij mbi funksionimin dhe përfaqësimin. Gjatë vitit 2016 FRESH, ashtu si më 2012, organizoi debat dhe votim kombëtar për zgjedhjet e drejtuesve të rinj të FRESH, bazuar në parimin e votimit në primare përmes anëtarësisë. Në dallim nga 2012, në këto zgjedhje FRESH eksperimentoi me votimin online të anëtarëve dhe mbështetësve të ndryshëm.

- Shpallja e zgjedhjeve dhe organizimi i debateve nuk u bë në bazë të statusit të FRESH, por me imponim nga lart, nga kryetari dhe sekretariati i PS. Kryetarja ende në detyrë e FRESH Joleza Koka e pranoi praktikën edhe për shkak të një debati kritik publik që shkaktuan disa deklarata të saj. Kryetari i PS lajmëroi krijimin e një grupi vlerësues të debatit dhe zgjedhjeve nëpër rrethe, proces i quajtur “FRESH VOICE” ku bënë pjesë anëtarë të kryesisë së PS P.Majko, Sekretaria për rininë në PS E.Spiropali, si dhe dy figura jopolitike, botuesja e librit “Kurban” dhe një aktor i emisionit i humorit “Portokalli”. Fakti se në juri vota politike dhe vota jopolitike kishte të njëjtën peshë, tregon se procesi më shumë synoi imazh & marketing publik sesa debat mbi idetë & platforma politike.
- Procesi ofroi risi në faktin se cilido individ në FRESH ishte i lirë të kandidonte dhe rreth 280 prej tyre hynë në një proces votimi elektronik. Sipas rezultateve zyrtare u njoftua se në votimin elektronik morën pjesë 110.675 persona, rreth 5-6 herë më shumë sesa anëtarësia zyrtare e FRESH, një tregues masiviteti, por edhe fiktiviteti në sistemin elektronik të votimit dhe administrimit. Nga votimi u evidentuan 20 kandidatët më me shumë vota, prej të cilëve kryesia e PS do të duhet të zgjedhë emrat që kalojnë për votim nga anëtarësia për kreun e ri të FRESH.
- FRESH llogariti rreth 40 mijë anëtarë, por në votimin 1 anëtar – 1 votë në tetor 2016, morën pjesë 24,851 anëtarë. Nga votimi fitues doli ish sekretari i përgjithshëm Eljo Hyska me rreth 10 mijë vota, ndjekur nga Shpend Kolgega me 7.7 mijë. Katër kandidatët e tjerë së bashku kishin më pak sesa 7 mijë vota.

- Bazuar në të dhënat zyrtare kandidati që mori mbi 10 mijë vota në votimin e anëtarësisë kishte fituar vetëm 5.7 mijë vota në votimin online kombëtar. Gjithashtu kandidati i dytë më i votuar nga anëtarësia kishte rreth 2.1 mijë vota më shumë sesa vota popullore në testin online. Kandidati me rezultatin më të ulët në votimin e anëtarësisë kishte 10 herë më shumë vota në votimin online. Këto të dhëna tregojnë se testi i votimit online, aplikuar në fazën e farë nuk ishte funksional dhe larg mbështetjes së vërtetë për kandidatët.
- ISP e monitoroi në aspekte të ndryshme garën e brendshme të FRESH dhe gjeti si risi (aplikimi për herë të parë në këtë formë dhe masivitet) ashtu edhe probleme që kanë të bëjnë me formësimin e legjitimitetit të procesit, cilësinë e kandidimit bazuar në programe, si dhe ndërhyrjet nga nivelet drejtuese partiake në zgjedhjet rinore. Mangësia kryesore e procesit zgjedhor lidhej me cilësinë e kandidatëve dhe vizionit të tyre politik. Shumica e prezantimeve të tyre ishin larg standardeve të elitës rinore e studentore në Shqipëri.
- FRESH, pas zgjedhjes së kryetarit, nisi procesin e zgjedhjeve të kryetarëve në rrethe. Në pothuajse të gjitha degët pati votim alternativ, dhe në përgjithësi zgjedhjet ishin korrekte. Pretendimet e ndryshme për parregullsi apo problematika të tjera teknike nuk e cenonë risinë në zgjedhjen e drejtuesve lokalë të FRESH, një standard të cilin PS nuk e ka zbatuar ende në nivelin partiak. Disa nga drejtuesit e tjerë qendrorë u zgjodhën gjithashtu me kompromis midis kandidatëve në garën për kryetar, si dhe në janar është paralajmëruar zhvillimi i Kongresit Kombëtar të kësaj organizate.
- Faqja zyrtare online e FRESH (<http://fressh.al/>) daton me informacione të rreth 1 viti më parë, nuk pasqyron program, status, ekipin drejtues, si dhe procesin e FRESH Voice apo zhvillimet e fundit në këtë organizatë. Shumica e dokumenteve identifikuese të saj, sidomos statusi dhe programi, janë prurje për herë të parë, janë drafte ende jo përfundimtare dhe janë tregues të procesit që po ndodh në FRESH, të kalimit nga një strukturë rinore formale në një strukturë rinore institucionale.

■ DBP NË FRPD: RISI DHE PROBLEME

Në fundin e vitit 2015 FRPD mbylli procesin e saj të parë historik të votimit me parimin “1 anëtar – 1 votë” për kryetarin e organizatës. Në të njëjtën kohë pjesë e votimit rivalizues midis kandidatëve të ndryshëm ishin shumica e degëve lokale, - duke ofruar një model pozitiv të pa-aplikuar ende nga vetë PD në strukturat e saj lokale e qendrore.

- Në vitin 2016 pritej që FRPD të thellonte stilin demokratik të organizimit dhe funksionimit. Në fakt, ndryshe nga pritshmëritë, FRPD harxhoi 10 muaj kohë për të arritur të zgjedhë ekipin drejtues, kryesinë, koordinatorët dhe sekretariatit. Në qershor 2016, 6 muaj pas zgjedhjes së kryetarit, u organizuan zgjedhjet për Këshillin Kombëtar. Në disa media pati të dhëna për lidhje familjare të brezit më të ri me brezin më të vjetër tradicional në PD, si dhe për probleme në përfaqësimin rajonal, - tregues kritikë në raport me risitë pozitive të garës për zgjedhjen e kryetarit të kësaj organizate. Kjo vonesë e pajustificueshme erdhi kryesisht për shkak të presionit nga nivelet e larta drejtuese të partisë dhe rivalitetit midis grupeve të ndryshme konkurruese.
- Vetë fakti që FRPD qëndroi 10 muaj strukturë drejtuese, 6 muaj pa Asamble dhe më pas edhe 4 muaj pa kryesi mbetet një problematikë e dukshme kritike. Për më tepër, kur sipas praktikës statusore do të duhej që brenda dy javësh të konstituohet Këshilli i Ri dhe të zgjidhet ekipi i ri drejtues (kryesia dhe sekretariati).
- FRPD ka zhvilluar aktivitete të shumta, - kryesisht formuese mbi edukimin demokratik e politik, - si dhe ka qenë prezent në disa ngjarje e aktivitete politike të PD, por ashtu si edhe FRESH nuk ka pasur dhe nuk ka ende një debat të brendshëm dhe as publik mbi identitetin e tij, raportin me partinë përkatëse politike, platformën për rininë dhe ofertat politike të rrugëzgjdhjes së problemeve të tyre.
- FRPD vijon të mos ketë faqe zyrtare online, duke mbetur formalisht e aksesueshme vetëm

në rrjetet sociale dhe në link-un e faqes zyrtare të PD. Për pasojë, FRPD ashtu si shumica e organizatave rinore politike në vend nuk ka bërë publike asnjë prej dokumenteve dhe të dhënave bazë të organizatës, përfshirë platformën, debatet, strukturën, organigramën, degët përbërëse, qëndrimet politike, financimin deri edhe të dhëna të kontaktit.

- Në tetor 2016 FRPD arriti të bëjë zgjedhjen e sekretariatit dhe koordinatorëve, duke ndjekur modelin organizativ të PD, një model i ndryshëm nga modeli tradicional i PD dhe FRPD përgjatë 26 viteve. Një udhëzim i kryetarit njoftoi afatin e kandidimit vullnetar për postet drejtuese, dhe me 15 tetor kandidatët alternativë u votuan. Në përfundim u zgjodhën Sekretari i Përgjithshëm, pesë nënkryetarët, 20 drejtuesit e Departamenteve dhe 9 Sekretarët, pra në total, 35 drejtuesit e FRPD, numri më i madh i posteve drejtuese në historinë e kësaj organizate.
- Produkti zgjedhor edhe në Këshillin Kombëtar edhe në stafin e ri drejtues, u ndesh edhe me kritika të ndryshme qoftë nga radhët e FRPD, qoftë edhe nga degët e PD, kryesisht për shkak të disproporcionalitetit të përfaqësimit të rretheve dhe kufizimit të konkurrencës në emra që kanë suport familjar nga nivelet e larta drejtuese në PD. Gjithsesi, FRPD e mbylli procesin e vet zgjedhor në nivel lokal e kombëtar, gjë që PD nuk arriti ta bënte përgjatë 2016.
- FRPD nuk ka adresë zyrtare në internet. Adresa e saj është në kuadër të PD, por në klikimin e saj nuk ka asnjë të dhënë për FRPD, përveç një formulari anëtarësimi. <http://www.pd.al/frpd/>.

■ DBP NË LRI: RISI DHE PROBLEME

LSI shpalli në prill nisjen e organizimit rinor në nivel studentësh, gjimnazistes dhe të rinjsh të tjerë, për të mbajtur Konventën Kombëtare me 9 qershor.

- Përgjatë muajit maj LSI zhvilloi aktivitete të shumta lokale në funksion të organizimit rinor, prej nga ku pritet të dalin edhe drejtuesit e rinj të forumit.
- Në qershor LSI organizoi zgjedhjet e reja në LRI (Lëvizja Rinore për Integrim). Në dallim nga FRESH dhe FRPD zgjedhjet në LRI nuk u bënë mbi bazën e anëtarësisë por mbi bazën e delegimit të votës. Në zgjedhjet zyrtare të mbajtura në 10 qershor, nga 2005 delegatë të regjistruar, 463 delegatë nuk morën pjesë në votim (shifër shumë e lartë për praktikën e votimit me delegatë). Midis dy kandidatëve kryesore, fitues i garës ishte Floida Kërpaçi me 1035 vota ndaj Klevi Pojana me 507 vota.
- Në vijim të procesit të ri zgjedhor, LRI mblodhi edhe Komitetin Drejtues Kombëtar, zgjodhi kryesinë dhe sekretarin e ri drejtues. Dy rivalët për kryetarë ndanë mes tyre dy postet më të larta drejtuese në LRI. Kjo mbetet një risi pozitive për këtë organizatë.
- LRI mbetet aktive sidomos në aktivitetet publike, megjithatë përpjekjet e sforcuara të saj për tu njësuar me emrin e kryetarit të partisë dhe gjithçka përfaqëson ai, e dobësojnë strukturën përfaqësuese, pavarësinë relative, modelin dhe impaktin publik të saj.
- LRI ka qenë aktive, sidomos në takimet e përvitshme në Jalë (Sarandë) ku ndërthuren pushimet verore me takimet politike me drejtues të së majtës në Shqipëri dhe të ftuar nga vende të ndryshme. LRI ka një faqe zyrtare online (<http://www.lri.al>), e cila nuk është aktive dhe publikimet e fundit datojnë disa vite më parë. Në faqen zyrtare nuk është pasqyruar asnjë ndryshim i LRI në ekipin drejtues apo aktivitete, ndërkohë që mungojnë dokumentet publike të programit politik dhe të statusit.

■ PARTITË DHE AKTIVITETI ZYRTAR ONLINE

- Trendi i ri, mediat e reja sociale, janë shndërruar në mekanizmat kryesorë të komunikimit të partive politike me strukturat e tyre dhe me elektoratin. Secila nga partitë politike, secili politikan drejtues dhe secila degë lokale, ka tashmë llogari të hapura në një prej rrjeteve sociale. Shumica e deklaratave dhe replikave politike, njoftimeve dhe fotove nga aktivitetet shpërndahen fillimisht përmes medieve sociale dhe më pas kalojnë në median tradicionale, vizive ose të shkruar.

ADRESAT ONLINE TË PARTIVE KRYESORE POLITIKE

• Adresa online e PS	http://ps.al
• Adresa online e PD	www.pd.al
• Adresa online e LSI	www.lsi.al
• Adresa online e PDIU	http://pdIU.al
• Adresa online e PR	http://prsh.al
• Adresa online e PAA	http://paa.com.al
• Adresa online e PBDNJ	http://al.pbdnj.com
• Adresa online e LZHK	http://lzhk.al
• Adrtesa online e PDK	www.pdk.al
• Adresa online e SFIDA	www.sfidapershqiperine.com
• Adresa online e LIBRA	http://libra.al/

- Në periudhën e nisjes së monitorimit vetëm katër parti politike kishin faqe në internet, edhe ato, me materiale simbolike prezantuese. Për shkak edhe të presionit pozitiv mediatik apo në komunikim direkt me partitë politike parlamentare (direkt ose indirekt parlamentare), është bërë e mundur që në fund të vitit 2016 të gjitha partitë – objekt të monitorimit të kenë faqe online, ku publikohen simbolist të dhënat e përgjithshme mbi to. Tabela ilustron emrat e partive dhe adresat e tyre online.
- Pjesa dominuese e partive politike vijojnë të kenë mangësi të dukshme në informacionin që përcjellin online, por trendi është ecja drejt një informacioni më cilësor dhe më konkurrues, sidomos përfshirja e adresave të kontaktit, ekipit drejtues partiak, programit dhe dokumentit bazë statusor, si dhe publikimi i aktiviteve/deklaratave më të rëndësishme politike.
-

■ DBP: GJETJET KRYESORE TË PARTIVE POLITIKE NË VLORË

Hartuar nga Silvana JAUPAJ, eksperte e Institutit të Studimeve Politike, Vlorë

HYRJE

Bashkia Vlorë konsiderohet prej vitesh një bastion politik i të majtës. Mandati i fundit drejtues i të djathtës në Vlorë është i vitit 1996 në zgjedhjet parlamentare e lokale. Prej atëherë (20 vjet) e majta ka pasur përfaqësim dominues parlamentar dhe ka drejtuar rregullisht bashkinë e Vlorës. Me ndarjen e re administrative Vlorë gjithashtu zgjerohet edhe me njësi të tjera dhe diferenca në vota midis dy krahëve politike mbetet e dukshme, krahasuar me shumicën e bashkive të tjera të mëdha të vendit.

Në zgjedhjet e fundit lokale (2015) në votimin në mazhoritar kandidati i të majtës mori rreth 32 mijë vota ndaj 17 mijë votave të kandidatit të djathtë, ose 61% me 33% të votave. Në votimin në proporcional koalicioni i majtë fitoi 68% të votave ndaj 27% të koalicionit të djathtë, PS si subjekt mori mbi 21 mijë vota, ndaj 10 mijë votave të fituara nga PD. Në Këshillin Bashkiak Vlorë e majta ka 29 këshilltarë dhe e djathta 11 këshilltarë. Në koalicionin e majtë PS ka 18 këshilltarë ndjekur nga LSI me 5 këshilltarë, kurse PD ka 9 këshilltarë ndjekur nga dy parti të vogla me nga 1 këshilltar.

Që prej zgjedhjeve parlamentare 2013 ka pasur ndryshime drastike në drejtimin e degëve të dy partive kryesor politike në Vlorë, PS e PD-së. Dy partitë ndryshuan krerët lokalë, dhe me organizimin e ri territorial, edhe organizimin lokal.

RAPORT MBI DEMOKRACINË E BRENDSHME DHE ZGJEDHJET NË PS VLORË

Partia Socialiste Vlorë zgjedhjet e fundit për kryetar i ka zhvilluar më 2012, kur ish zv/kryetar i bashkisë Edmond Leka rezultoi fitues me 20 vota më shumë në rivalitet me Gjergj Haziraj. Në zgjedhjet 2013 PS rezultoi fituese dhe kryeministri Rama u bë deputet i saj. Pas zgjedhjeve parlamentare dhe në prag të zgjedhjeve lokale PS Vlorë nisi një proces ri-organizimi të plotë.

- Mandati legjitim i kryetarit të degës ka skaduar, ndaj në rrethana të tilla nuk u operua me zgjedhje të reja, por me praktika kalimtare emërimi, deri në ri-organizimin e plotë nga poshtë të partisë. Procedura e ndjekur për përzgjedhjen e kandidatit/kandidateve për kryetar, të cilët me miratimin e kryesisë së PS kalojnë për votim në asamblenë socialiste në Vlorë, kanë krijuar debate mbi nivelin e transparencës, përfaqësimit dhe sistemin e meritokracisë.
- Në planin organizativ PS operoi me emërimin e koordinatorëve lokalë kombëtarë, përfshirë edhe qarkun e Vlorës dhe Gjirokastrës, ku koordinator u caktua deputeti Koço Kokëdhima, një nga bashkëpunëtorët më të afërt të kryeministrit dhe kryetarit të PS-së, Edi Rama. Në funksionin e tij lokal ai inicioi një proces të plotë ri-organizimi, i cili nuk ishte në përputhje të praktikës statusore të PS, por shërbeu si eksperiment lokal për vetë këtë parti. Praktika e re e caktimit të koordinatorëve për partinë, për rininë dhe për gruan, - të gjithë në nivel qarku, dhe më pas edhe në nivel bashkie, tentoi të bëjë regjistrimin e ri të anëtarësisë, zgjerimin e anëtarësisë si dhe zgjedhjen nga e para të drejtuesve të bazës, për të arritur më pas tek drejtuesit kryesor në nivel bashkie dhe qarku.
- Në fundin e muajit maj u zhvilluan zgjedhjet për kryetarët e rinj të degëve. Në Vlorë kryesia qendrore e PS miratoi dy kandidatë, njëri dha dorëheqjen më pas, ndaj mbeti në garë formale vetëm 1 kandidat. Anduen Tahiraj, një figurë e re lokale e PS Vlorë u zgjodh me 221 vota pro dhe 21 kundër. Pas zgjedhjes ai tha se PS Vlorë përpara reformimit 2015-2016 kishte vetëm 1650 anëtarë, ndërsa në maj 2016 regjistron 8500 anëtarë, ajo është *“shumë më e re në moshë, është çliruar nga fiktiviteti, është e gjitha aktive dhe me një strukturë politike tërësisht të përtërirë, me një strukturë sociale përfaqësuese e të balancuar”*. Pikëpamjet e tij ndeshen me kritika nga pjesa tradicionale e PS-së Vlorë, e cila akuzuan strukturën aktuale për formalizëm, krijim të strukturave paralele, si dhe kufizim të demokracisë konkurruese në parti.

- Në fjalimin në Kongresin e PS koordinatori për Vlorën raportoi se përpara procesit zgjedhor në Vlorë dhe qark, *“në disa territore ishin shpërbërë pothuajse krejtësisht organizatat socialiste. Në disa raste OS-të ishin ngritur me të gjithë anëtarët nga një familje apo nga një fis, kishim shumë kryetarëve të OS-ve që nuk zgjidheshin prej më shumë se 10 vjetësh, pa folur për ato raste kur kishim kryetarë pa organizata. Rreth gjysma e anëtarësisë ishte fiktive në regjistrat tanë të anëtarësisë. Struktura ishte e mbyllur, e kalcifikuar ose jo atraktive për anëtarësim të reja. Disa drejtues i konsideronin OS-të si pronë personale, madje edhe si një pronë e trashëgueshme”*. Sipas koordinatorit të qarkut Kokëdhima (qëndrim, i cili është edhe qëndrim zyrtar i PS Vlorë) parimi mbi të cilat u zhvilluan zgjedhjet e brendshme dhe ri-organizimi në PS ishte *“një person, një funksion në parti”*. Në listën e delegatëve në Kongres, më pas të të zgjedhurve Asamble dhe në nivelet drejtuese në bashki, dominuan prurjet dhe emrat e rinj. PS raportoi se të gjitha zgjedhjet në organizatat socialiste u bënë me votim të fshehtë dhe midis dy kandidatëve, dhe se 82% e drejtuesve të organizatave bazë janë zgjedhur për herë të parë, dhe se 70% e të zgjedhurve janë nën moshën 40 vjeç.
- Në votimin e datës 5 mars për delegatët në nivel bashkie u zgjodhën 29 delegatë, 15 “shokë” dhe 14 “shoqe”, shumica delegatë për herë të parë në historinë e përfaqësimit të PS-së. Zyrtarisht u njoftua për pjesëmarrje të lartë në votim dhe për rreth ¼ e anëtarësisë së re të përfshirë në procesin zgjedhor. Në kundërshtim me praktikën statusore të PS, Vlora ishte e vetmja njësi ku një deputet i PS e përfshiu emrin e tij në listën e delegatëve, megjithëse deputetët duhej të ishin automatikisht delegatë. PS Vlorë e konsideron sukses faktin, sipas tyre, se është qarku i parë që ka krijuar një database të detajuar mbi anëtarësimet në parti, të dhënat mbi profesionin dhe angazhimin politik, si dhe mbi kontaktet elektorale në çdo nivel, nga bashkia qendrore në njësitë e vogla më të largëta.
- Pas zgjedhjes së delegatëve dhe të drejtuesve të njërive bazë, ngjarja e dytë më e rëndësishme në Vlorë ishte zhvillimi i referendumit të datës 9 prill. Në nivel qarku Vlorë PS njoftoi pjesëmarrjen e 81% të anëtarëve ose 17626 votues. Prej tyre, 93% votuan “po” dhe 7% alternativën “jo”. Në nivel bashkie në Vlorë PS regjistroi 7043 votues, nga të cilët 92% votuan “po” dhe 8% votuan “jo”.
- I gjithë procesi i zgjedhjeve në Vlorë dhe njësitë e tjera të përfshira në qark, ka shkaktuar debate të brendshme politike në PS, deri edhe në nivel kombëtar (debate në Asambleenë Kombëtare, në Kongres, ose në mediat publike). Mosmarrëveshjet kanë të bëjnë kryesisht me legjitimitetin e praktikave zgjedhore dhe me raportin e koordinatorit të rajonit/qarkut/bashkisë me strukturat ekzistuese, grupin parlamentar dhe ekipet tradicionale drejtuese në Vlorë. Kritikët e kësaj praktike, edhe ata deputetë ose figura politike që kanë drejtuar bashkinë Vlorë ose organizatat lokale të saj, janë skeptikë për rezultatin e arritur, cilësinë e zgjedhjeve dhe e vlerësojnë procesin kundër efektiv në raport me pritshmëritë dhe synimet elektorale 2017. Kritikët kanë të bëjnë me prurjet e reja, të cilat, sipas zërave kritikë, janë pa përvojë, pa lidhje identitare me PS-në, me procesin e emërimeve në drejtimin e PS-së, si dhe me fiktivitetin e votimit për delegatë, për zgjedhjen në strukturat bazë dhe për referendumin. Gjithsesi nuk ka pasur asnjë dokument të shkruar zyrtar ku kritikët adresohen dhe as nisma brenda PS për mocion mosbesimi apo për ankim në strukturat përkatëse të krijuara me status. Fakt mbetet se praktika e ndjekur në organizimin e PS në Vlorë dhe njësitë e tjera të qarkut është unike, dhe nuk është aplikuar në 10 qarqet e tjera, duke përjashtuar Gjirokastrën.
- Pas Kongresit PS Vlorë pësoi një tronditje, për dy arsye: e para sepse koordinatori i kryesisë së PS që mbulon Vlorën humbi mandatin parlamentar dhe pas një periudhë të lënë pezull, u caktua një koordinatori i ri, ministri Gjinkuri. E dyta, sepse rivaliteti midis prurjeve të reja në parti dhe bazës së vjetër, u reflektua edhe në diferencat në qëndrime midis deputetëve të Vlorës.
- Sipas praktikave organizative PS do të duhej të kishte zhvilluar mbledhje të rregullta kryesie, ku marrin pjesë edhe deputetët (kryeministri vetë është deputet në Vlorë), si dhe të analizonte problematikat e pakënaqësitë, për tu dhënë atyre zgjidhje përmes votimit dhe praktikave të tjera demokratike. Në rastin e Vlorës nuk ndodhi as njëra dhe as tjetra. Nuk pati mbledhje dhe as analizë, nuk pati përfshirje publike të kryeministrit – deputet në konfliktin e dy linjave paralele në PS-në lokale, por nga ana tjetër nuk u vu në diskutim legjitimiteti i degës lokale dhe kryetarit lokal të PS zgjedhur përmes votimit.

- Boshti i kritikave dhe debatit mbi gjendjen e PS Vlorë është i lidhur me raportin e pushtetit që kjo parti zotëron dhe ushtron në krahasim me pushtetin e individëve të veçantë. Një numër figurash lokale të majta drejtuese gjatë viteve të tranzicionit kanë shprehur kritika për zhvendosjen e tyre dhe skemën e re organizative të aplikuar në Vlorë, kurse drejtuesit e rinj kanë qenë dhe mbeten mbështetës i linjës së tyre reformuese dhe kryesisht promovuese për një brez të ri politik në vendimmarrjen lokale.
- Në dallim nga praktikat e kaluara nuk ka pasur raste të debatit midis drejtuesve lokalë të PS dhe drejtuesve lokalë në Bashki, si dhe nuk ka pasur as deklarata publike për marrje në mbrojtje të bashkisë nga sulmet e ardhura nga pjesa opozitare. Në rastin e Vlorës duket me PS dhe bashki duket se kemi të bëjmë me dy segmente që ecin paralelisht por që kanë mirëkuptim të plotë për shkak se të dyja palët reflektojnë qëndrimet politike të lidhshme të PS në Tiranë. Bashkia ndjek linjën e kryetarit të PS, dega lokale ndjek linjën e ish deputetit të zonës, por për shkak se debatet nuk kanë çuar në konflikt dhe as nuk janë sqaruar publikisht, as palët lokale nuk kanë mbajtur pozicione preferenciale.
- Prej muajit shtator u evidentuan disa ndryshime që shprehin drejtimin e ri lokal nga koordinatori dhe rinj qëndrorë. Kështu, sekretari organizativ dhe 8 kryetarë të organizatave lokale u ndryshuan, ndryshime pati edhe në nivele komisionesh dhe strukturash të tjera organizative. Muajt e fundit struktura e PS Vlorë është fokusuar në përgatitjet për fushatën e ardhshme elektorale. PS Vlorë organizoi edhe zgjedhjet për kreun e ri të FRESH, si dhe ka ngritur tashmë strukturat lokale sipas skemës kombëtare të organizimit.
- Një aspekt tjetër me rëndësi për demokracinë e brendshme dhe konceptin e transparencës publike është se PS Vlorë nuk ka faqe zyrtare në internet, nuk ka të dhëna publike të verifikueshme për opinionin jashtë organizimit partiak, nuk ka media dhe as mekanizma të tjera publik të prezantimit, siç edhe nuk ka të dhëna publike mbi shpenzimet dhe burimet e financimit.
- PS Vlorë nuk ka organuizuar konferenca apo takime me median dhe grupet e interesit, ka funksionuar më shumë në dispozicion të axhendës politike (aktivitete që kërkohen nga qendra ose shoqërim i kryeministrit gjatë aktiviteteve të tij edhe si deputet në Vlorë), si dhe nuk ka pasur mbledhje të përbashkëta midis partive aleate në qytet.

RAPORT MBI DEMOKRACINË E BRENDSHME DHE ZGJEDHJET NË PD VLORË

Pas humbjes së thellë në zgjedhjet parlamentare (2013) drejtuesit e PD-së Vlorë dhanë dorëheqje dhe në procesin e ri zgjedhor (2014), kandiduan Valbona Mezini dhe Moisi Meminaj. Në përfundim të votimit nga delegatët e mbledhur në konferencën e rrethit Vlorë, Meminaj fitoi 260 me 170 vota. Vlen të theksohet se votimi ishte në fazën e dytë të balotazhit, pasi më parë 14 kandidatë synuan postin e kryetarit lokal. Ky detaj ka vlerë për të kuptuar frymën e rivalitetit pozitiv midis demokratëve të Vlorë, në kushtet e reja të jetës politike në opozitë.

- Mandati i Meminaj, sipas statusit të PD-së, vlen deri më 2018, pra deri pas zgjedhjeve parlamentare 2017. Megjithatë, përmes një vendimi të kryesisë së PD në prill 2016, dega e Vlorës ishte një nga 35 degët e përzgjedhura për të kaluar në zgjedhje të reja të parakohshme. Motivimi zyrtar lidhej me ndarjen e re administrative, si dhe me nevojën e një partie më aktive dhe më të organizuar në prag të zgjedhjeve parlamentare të radhës vitin e ardhshëm.
- Përpara këtij vendimi, PD Vlorë nuk kishte bilanc të rëndësishëm të zhvillimeve të brendshme demokratike. Në fundin e vitit të kaluar PD Vlorë u angazhua në zgjedhjet 1 anëtar – 1 votë që u zhvilluan në FRPD, si dhe në çështje të organizimit të brendshëm, kryesisht në rolin e “qeverisë në hije” për problematikat lokale që shqetësojnë qytetarët e Vlorës.
- Vendimi i kryesisë së PD për zgjedhje të reja në Vlorë u shoqërua me debate të ashpra publike dhe reagime kritike nga drejtuesit e PD Vlorë. Përmes prononcimeve në mediat lokale dhe kombëtare, si dhe takimeve me strukturat e anëtarësisë ku u iniciua edhe një peticion adresuar kryesisht dhe

kryetarit të PD-së z.Basha, u shpreh pakënaqësia me vendimin dhe ai u konsiderua anti-statutor. Kryetari degës Meminaj deklaroi se nuk qëndron alibia e dhënë nga kryesia për ri-organizim për shkak të ndarjes së re territoriale. Më 11 maj ai hodhi poshtë edhe pretendimin se rreth 1/3 e kryesisë së zgjedhur më 2014 shpërndahet në dy bashkitë e tjera, Himarë e Selenicë, duke thënë se vetëm 8 nga 35 anëtarët e kryesisë preken nga kjo ndarje e re territoriale. Më herët, më 9 maj Meminaj e quajti vendimin për ri-organizimin e PD Vlorë “një vetëvrasje politike vetëm një vit përpara zgjedhjeve parlamentare”. Ai tha se e gjithë baza e partisë ka të njëjtin opinion dhe se në tërësi, janë 21 kryetarë degësh të PD që janë kategorikisht kundër urdhrin për zgjedhje të reja në mesin e mandatit të tyre statusor. Reagimi më i plotë i kryesisë së PD Vlorë dhe drejtuesve lokalë erdhi vetëm disa ditë pas vendimit për ri-organizim. Në këtë reagim (3 maj 2016) e konsideroi vendimin e kryesisë së PD “një pushkatim pa gjyq”, tha se nuk është respektuar statusi dhe nuk është marrë mendimi i bazës së partisë, fajësoi direkt personat e deleguar nga qendra për situatën e krijuar dhe manipulim të së vërtetës, etj. Kryesia e PD Vlorë shprehu bindjen se vendimi për shkrirjen e saj u bë pa analizë, pa kritere të qarta, pa konsultim, selektiv dhe për interesa të ngushta klanore në kupolën e lartë drejtuese. Ata i bënë thirrje kryetarit Basha dhe kryesisë së PD të rishikojnë vendimin, - kërkesë që nuk u mor në konsideratë.

- Në tërë kronologjinë lidhur me vendimin për kalimin e degës së PD Vlorë në zgjedhje të reja, si dhe për pasojë, në ndërprerjen e mandatit statusor të tyre, ajo që bën dukshëm përshtypje është mungesa e rregullave të shkruara dhe e mekanizmave statusorë që shqyrtojnë dhe zgjidhin mosmarrëveshjet në raste të njëjta. Të kontaktuar zyrtarët e PD Vlorë pranuan se nuk kanë bërë apelim të vendimit në Komisionin e Apelit në parti, organizëm i përcaktuar në rolin e gjykatës në parti, në raste të konflikteve të tilla statusore dhe të kompetencave. Gjithashtu, kronologjia dëshmon për probleme të theksuara komunikimi midis strukturave qendrore të PD-së dhe strukturave lokale të PD Vlorë. Kjo bëhet edhe më e dukshme nga fakti se menjëherë pas vendimit, u ndryshua i ngarkuari i kryesisë së PD për rrethin e Vlorës.
- Deri në fundin e vitit PD Vlorë nuk e ka zgjidhur ende problematikën e kryetarit, ndërkohë që ish kryetari lokal me deklarata publike e ka distancuar veten e tij nga partia zyrtare. Ironikisht ky qëndrim lehtëson hapësirën e qendrës për të ndërhyrë për zgjidhje emergjente ose përfundimtare, por vonesat në veprim, në zgjedhjet në seksione, rivalitetet e brendshme dhe debati përmes medias, kanë ndikuar në zgjatjen e procesit jashtë cdo parashikimi. Argumenti kryesor i degës lokale për shtyrjen e procesit nuk lidhet, sipas tyre, me konflikte të brendshme, por me problematika teknike të realizimit të ndarjes së re të degës Vlorë, sipas skemës së re organizative, në degë të re në Selenicë, në Himarë dhe në bashkinë Vlorë. Deri në zgjedhjet finale të degës kryesia e vjetër dhe strukturat e vjetra drejtuese kanë mandat përfaqësimi dhe në përgjithësi deklarohet se janë në funksion.
- Në aspektet e tjera organizative PD Vlorë nuk ka pasur ngjarje të matshme dhe as të dhëna referuese. Nuk ka ndryshime në strukturat e kryesisë dhe as në strukturat përfaqësuese, në organizatën e rinisë dhe të as të gruas. Në përgjithësi PD Vlorë gjatë muajve të fundit është fokusuar në aksionin politik kundër qeverisjes së majtë të qytetit dhe qeverisë së majtë në Tiranë dhe jo në çështje të brendshme partiake. Të tilla ishin protesta publike e një grupi aktivistësh të saj kundër disa parullave të periudhës komuniste shfaqur në disa vende publike, si dhe oponenta ndaj politikave lokale të bashkisë Vlorë.
- Dega e PD Vlorë nuk ka të dhëna publike mbi programet e punës, strukturën, vendimmarrjen, kontaktin, databasën, financimin dhe element të tjerë të rëndësishëm për imazhin dhe besueshmërinë publike të një partie politike. PD Vlorë nuk ka faqe internet, media dhe as adresar tjetër publik, por është fokusuar kryesisht në rrjetet sociale. Në analizën e rrjeteve sociale (referuar PD Vlorë) bie në sy ligjërimi politik që lidhet me problemet e shqetësimit ditore, si dhe përpjekja për të bërë share lajmeve zyrtare që vijnë nga selia qendrore në Tiranë, sidomos lajme që kanë burim kryetarit Basha dhe ish kryetarit Berisha. Referimet mbi figurat e tjera politike të PD qendrore mungojnë.

RAPORT MBI DBP NË PARTITË E TJERA TË BASHKISË VLORË

Në përgjithësi degët lokale Vlorë të partive të tjera politike, me përjashtim të PDIU, nuk kanë mbajtur procese zgjedhore dhe as nuk kanë zhvilluar aktivitete politike organizative. Dega e LSI në periudhën e tretë të vitit pati një zhvendosje publike majtas, në drejtim të PS, kryesisht për shkak të mosmarrëveshjeve midis drejtuesve lokalë e qëndrorë të kësaj partie. Aktualisht LSI nuk ka kryer të zgjedhur, por ka emëruar një koordinator për bashkinë dhe qarkun.

- PDIU është partia e vetme politike që zhvilloi edhe në Vlorë zgjedhje të rregullta statusore për kryetarin lokal dhe për kryesinë lokale. Në zgjedhjet e zhvilluara me 21 maj në Vlorë, gara për kryetarin e PDIU midis Idrizit dhe Hysenit u fitua me mbi 80% të votave nga kryetari Shpëtim Idrizi. Gjithashtu në garën për drejtues lokal të degës së PDIU Vlorë fitues rezultoi Nikolin Hasani me 72% të votave. Sipas të dhënave të marra nga PDIU Vlorë, në këto zgjedhje u thirrën 1400 votues dhe në votim morën pjesë 75.5% e tyre. zgjedhjet u zhvilluan me parimin “1 anëtar – 1 votë” dhe nuk pati asnjë raport mediatik për kontestime apo pretendime për parregullsi. Interesant është fakti se në këto zgjedhje në Vlorë nuk u përfshi deputeti D.Tahiri, i cili në dy mandate radhazi ka qenë deputet i PDIU për qarkun Vlorë. Mospërfshirja e tij është akt konkret distancimi dhe identifikimi të mëtejshëm me Partinë Demokratike, në strukturat e të cilës tashmë bën pjesë. Nga burime lokale të PR, Tahiri pritet t’i bashkohet kësaj partie në zgjedhjet ardhshme parlamentare.
- Duhet theksuar se PS, PD dhe LSI zhvilluan konventat lokale të organizatave rinore, FRESH dhe LRI. Zgjedhjet lokale në tërësi ishin cilësore dhe konkurruese në secilën organizatë, gjithsesi në nivel kombëtar përfaqësimi i degës së Vlorës në strukturat e këtyre organizatave rinore mbeti simbolik, - një bilanc kritik për përfaqësimin e rinisë politike të Vlorës në vendimmarrjet qendrore të partive.

■ DBP: GJETJET KRYESORE TË PARTIVE POLITIKE NË SHKODËR

Hartuar nga Ardita REÇI, eksperte e Institutit të Studimeve Politike, Shkodër

HYRJE

Bashkia Shkodër konsiderohet një bastion politik i të djathtës. Kjo edhe për shkak të historikut të zgjedhjeve dhe garave të fituara kryesisht nga kandidatët e PD, që prej vendosjes së regjimit politik pluralist në vend.

Që në zgjedhjet e para, të 26 korrikut 1992, kur garuan për postin e kryetarit të Bashkisë Shkodër përfaqësues të 5 grupimeve politike, fitoi kandidati i PD, Filip Guraziu. Edhe Këshilli i Bashkisë dominohej nga kjo parti; 15 PD, ndaj 4 PS, 1 PR e 1 PSD. Në zgjedhjet e dyta, të 20 tetorit 1996 zgjedhjet për drejtimin e bashkisë i fiton me balotazh grupimi politik “E Djathta e Bashkueme Shkodrane”. Kjo ishte e vetmja herë kur drejtimi i Bashkisë Shkodër nuk ishte në duart e PD, e cila ishte partia humbëse e balotazhit. Deri në zgjedhjet e 1 tetorit 2000, ky institucion u drejtua nga Bahri Boriçi. Përbërja e Këshillit të Bashkisë ishte; PD e aleatët e saj 11 vende, “E Djathta e Bashkueme Shkodrane” 4 vende, PS e aleatët saj 6 vende. Zgjedhjet 1 tetorit 2000 ku rezultuan me fitoren e kandidati të PD, Ormir Rusi. Kjo parti kishte maxhorancën edhe në Këshillin e Bashkisë, së bashku me partitë aleate të spektrit të djathtë. Në zgjedhjet e 12 tetorit 2003 fitoi Artan Haxhi i PD. Në zgjedhjet e 18 shkurtit 2007 fitoi Lorenc Luka i PD, ashtu si edhe ato të 8 majit 2011.

Rezultatet e zgjedhjeve të fundit, 21 qershor 2015, gjithashtu shkuan në favor të kandidatës demokrate Voltana Ademi, e cila fitoi kundrejt rreth 39 mijë vota, pothuajse 10 mijë më shumë se kandidatja e së majtës Ketii Bazhdari. Kandidatit të pavarur Vullnet Elbasani mori mbi rreth 1700 vota. Ndërsa në Këshillin Bashkiak 27 mandate u fituan nga përfaqësues të koalicionit të djathtë Aleanca për Punë dhe Dinjitet, me 34 481 vota, ose 50.95% (21 këshilltarë PD, 2 këshilltarë PR, 1 këshilltar MDL, 1

këshilltar PBKSH, 1 këshilltar POSH dhe 1 këshilltar PAA). Koalicioni i majtë Aleanca për Shqipërinë Europiane mori 24 mandate, me 29609 vota ose 43.75% (9 këshilltarë PS, 10 këshilltarë LSI, 1 këshilltar FRD, 1 këshilltar PSM, 1 këshilltar PLD, 1 këshilltar PDK, 1 këshilltar PSD). Gjithsej 51 këshilltarë, përfaqësues të bashkisë së zgjeruar tashmë edhe me 10 njësi të tjera territoriale, pas ndarjes së re administrative. Votat për Këshillin Bashkiak ndryshuan edhe renditjen e partive në Shkodër, ku partia e dytë më e madhe me përfaqësi në këtë organizëm, pas PD, renditet LSI për t'u ndjekur nga PS që kalon në vendin e tretë.

RAPORT MBI DEMOKRACINË E BRENDSHME DHE ZGJEDHJET NË PS SHKODËR

Partia Socialiste Shkodër gjatë viteve të fundit ka pasur zhvillime intensive, kryesisht për shkak të konfliktit politik midis qendrës dhe disa deputetëve të këtij qarku.

- Me urdhër, në vitin 2013 nga drejtimi i PS Shkodër shkarkohet Gëzim Uruçi. Deri në zgjedhjet e 27 majit, detyra e kryetarit të partisë i ishte ngarkuar deputetëve Mimoza Hafizi për qytetin dhe Namik Kopliku për fshatin. Më 27 maj 2016 u zhvilluan zgjedhjet e reja dhe kryetar i PS u zgjodh Arvit Osja. Kandidatura e zgjedhur e Osjes, erdhi me emërim nga kryesia e partisë, fakt për të cilin ka patur debate dhe pretendime nga ana e anëtarësisë së kësaj partie për shkelje të nenit 31 të Statutit të PS. Diskutimet kanë vijuar në lidhje me moszbatimin e parimit “një anëtar, një votë” për Asamble. Kjo e fundit ka zgjedhur 11 kandidatura, nga të cilat me vendim është miratuar vetëm Osja.
- Për sa i përket aspektit organizativ, zgjedhjet i drejtuan anëtarët e Asamblesë, delegatët e Kongresit dhe deputetë. Ndërsa koordinatori lokal ishte Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati, i cili nuk i ka kursyer notat e diplomacisë edhe për menaxhimin e situatës zgjedhore brenda partisë. Kur Bushati është caktuar në rolin e koordinatorit, ka gjetur mjaft problem organizative, të cilave e ka pasë të vështirë t'u japë zgjidhje. Anëtarët janë shprehur se riorganizimi, që ka qenë një ndër detyrat e tij, nuk ka qenë në përputhje me statutin e PS.
- Në organizimin e zgjedhjeve u zbatua parimi i prurjes së kandidatëve nga Asambleja. Ndërsa në listën e delegatëve për Kongres u përfshinë jo ata që u propozuan nga strukturat për njohjet personale të delegatëve. Morën pjesë në kongres persona nuk ishin ende as anëtarë të partisë, si aktori Bruno Shllaku, apo anëtarë të rinj e pa kontribute në parti. Gjithsej ishin 4 gra dhe 7 burra. Vetëm 2 ishin përsëritës, të tjerët të gjithë të rinj. Anëtarësia ka pasur shpesh ankese, të reflektuara edhe në mediat lokale, se në Shkodër ka fiktivitet dhe komisioni ka bërë përzgjedhje sipas një grupimi të caktuar.
- Në referendumin e datës 9 prill pjesëmarrja në nivel qarku në Shkodër ka qenë e kënaqshme, në masën 93%, që do të thotë 1400 anëtarë të saj. Ky proces i zgjedhjeve në Shkodër dhe njësitë e tjera të përfshira në qark, ka shkaktuar debate të brendshme politike në PS. Deputetja Socialiste Mimoza Hafizi i ka drejtuar një letër komisionit Zgjedhor të Partisë Socialiste të Bashkisë Shkodër, ku pretendonte se PS - bashkia Shkoder kërkon të njihet në mënyrë zyrtare me përbërjen e re të komisionit. Hafizi kërkon edhe arsyen e mosmbledhjes së këtij komisioni, si dhe listat me adresat e të gjitha qendrave të votimit në Bashkinë Shkodër. Ndërsa pika e fundit e Hafizit edhe kërkesa për të kontaktuar me komisionin Zgjedhor me qëllim për të akredituar vëzhguesit e saj për procesin e referendumit në Bashkinë Shkodër.
- Më 27 Qershor, deputetja socialiste e Shkodrës Mimoza Hafizi ka paraqitur në parlament nismën për ndryshime kushtetuese, të firmosur nga 10 deputetë të majtë e të djathtë. Kjo nismë që sugjeron që Presidenti i Republikës të zgjidhet nga populli, ka patur jehonë edhe në Shkodër dhe është trajtuar mjaft në rubrikat e lajmeve dhe debate në mediat lokale. Më 1 Korrik u zhvilluan zgjedhjet për kryetar të PS në Bashkinë Vau i Dejës, ku fitues shpallet Kristjan Shkreli. Ai u shpreh para mediave se procesi i votimi, ku garonte përballë Mark Zhurit shkoi pa probleme. Shkreli ka qenë ish drejtues i Komunës Temal. Në zgjedhjet e 1 Korrikut mori 32 vota, kundrejt 28 votave që mori Zhuri. Shkreli deklaroi se përçarjet në PS e Vaut të Dejës janë shuar dhe se socialistët janë bashkuar. Më parë nga kjo degë e PS u rrëzua kandidatura e vetme e Sokol Shkrelit dhe anëtarët e partisë kërkuar një garë mes dy kandidatëve.

- Edhe në Malësinë e Madhe zyrtarisht ka fituar Lulzim Zira, si kandidat i vetëm në votim. Në Bashkinë e Pukës Marash Kola, në Fushë-Arrëz, Paulin Peraj. I gjithë procesi është pasqyruar lirisht nga mediat lokale, ku janë përfshirë edhe mendimet e ndryshme brenda rrallëve të anëtarësisë së PS.
- Gjatë muajit shtator dominues në Shkodër ishte debati politik midis kryeministrit Rama dhe kryetares së bashkisë Ademi. Mbledhja e kryesisë së zgjeruar lokale nën drejtimin e kryeministrit ka trajtuar kryesisht ndryshime në drejtorët rajonalë që varen nga qeveria qendrore, dhe probleme organizimi. Kryetëmë e takimeve të kryeministrit në Shkodër e Vau i Dejës ishin punësimet dhe kërkesat nga militantët për vende pune në administratën me varësi qendrore.
- Më 9 tetor, deputeti socialist i Shkodrës Namik Koplaku, tha për mediat se largimi i deputetes Mimoza Hafizi, e cila u largua nga rradhët e anëtarësisë së PS, për t'iu bashkuar nismës e më tej partisë së Ben Blushit, të emërtuar Libra, shënon një humbje të dytë në strukturat socialiste të Shkodrës pas Tom Doshit. Koplaku tha se ndërkohë që beteja elektorale parlamentare e vitit 2017 po afron, nuk e sheh suksesin e PS tek emrat e përveçëm, por tek skuadra. Aktualisht Partia Socialiste e qarkut Shkodër përfaqësohet në parlament me dy deputetët Namik Koplaku dhe Paulin Sterkaj, nga 4 që fitoi më 2013.
- Më 30 tetor PS Shkodër njoftoi fillimin e organizimit të kësaj force për zgjedhjet e ardhme parlamentare. Në mbledhjen e zgjeruar të kryesisë i pranishëm në takim ka qenë edhe koordinatori për Shkodrën, Ministri Bushati. Interesante është fakti se mbledhja u zhvillua në dy seanca, një pjesë e parë me strukturat partiake dhe një pjesë e dytë vetëm drejtorët e institucioneve lokale, të cilët me ligj duhet të jenë jopartiak dhe produkt i meritës/konkursit civil.
- Në fund të tetorit, përfundoi edhe procesi zgjedhor për kryetarin e ri të FRESH. Më 23 tetor u raportua se qarku i Shkodrës ka nxjerrë fitues në këto zgjedhje kandidatin Elsamed Muka, e cila në rang kombëtar humbi garën për kryetare. I vetmi problem i hasur në votimet e FRESH ishte dublikimi i emrave në lista, që sipas anëtarit të komisionit zgjedhor, ka qenë jo i rrallë si fenomen.
- Më 6 nëntor kreu i FRESH Shkodër Xh. Halili dha dorëheqje nga posti dhe gara. FRESH hyri në zgjedhjet e radhës me figura të tjera rinore, një proces që përmbyll zgjedhjet në nivel kombëtar të kësaj organizate.
- Një aspekt tjetër me rëndësi për demokracinë e brendshme dhe konceptin e transparencës publike është se PS Shkodër ajo ka faqe zyrtare në internet, por referuar burimeve zyrtare, «për mungesë personeli» nuk përditësohet me të dhëna mbi aktivitetet e partisë. Ndërsa të dhëna publike të verifikueshme për nivelin e shpenzimeve dhe burimet e financimit të part nuk ka të dhëna publike të verifikueshme për opinionin jashtë organizimit partiak, nuk ka media dhe as mekanizma të tjera publik të prezantimit, siç edhe nuk ka të dhëna publike mbi shpenzimet dhe burimet e financimit të partisë nuk ka.

RAPORT MBI DEMOKRACINË E BRENDSHME DHE ZGJEDHJET NË PD SHKODËR

Pas humbjes së zgjedhjeve të fundit parlamentare (2013), Partia Demokratike ka bërë riorganizime për përgatitjet e strukturave për zgjedhjet e vitit 2017.

- Koordinator për qarkun Shkodër gjatë 2016 u emërua Arben Ristani, sekretar i përgjithshëm i PD. Lidhur me zgjedhjet në degën lokale të PD ka funksionuar një grup pune i mbyllur, i përbërë nga Ristani, Greta Bardeli (kryetarja e zgjedhur e Qarkut Shkodër), Hysni Burgaj, Ramadan Likaj dhe Mimoza Rexhvelaj.
- Me 29 korrik, vetëm një ditë para zgjedhjeve për Kryetar të PD në njësinë administrative Velipojë, janë shfaqur pakënaqësi, të cilat në mediat lokale janë etiketuar si “përçarje” në PD-në e kësaj njësie. Anëtarët e këtij seksioni kanë pretenduar se drejtuesit politikë në Shkodër dhe kopordinatori i qarkut kanë mbështetur persona që kanë bërë fushatë për të majtën. Situata në këtë njësi u rëndua

së tepërmi dhe u kalua deri në përplasje fizike ndërmjet simpatizantëve të konkurentëve. Në garë për drejtimin e PD në Velipojë ishin Altin Kaçi, Sandër Viluni dhe Nikolla Marku. Nikolla Marku rezultoi fitues, ku nga 24 votues ai mori 13 vota, rivalët e tij 10 vota. Fituesi u sulmua ashpër nga PS lokale për shkak të një procesi gjyqësor në vijim, akuzë që nuk solli ndryshime në këtë njësi.

- Më 31 korrik, PD e Vaut të Dejës ka mbajtur Kuvendin e parë Zgjedhor, ku u konkludua me votimin për kryetarin e ri të kësaj dege të PD. Në përfundim të numërimit të votave, fitues u shpall Agim Bushati, i cili mori 82 vota, përballë kandidatit tjetër Nikolin Kaçi i cili mori 26 vota. Më 5 Gusht u mbajtën zgjedhjet për kryetar të PD në Malësinë e Madhe, ku fitues rezultoi Anton Kokaj me mbi 95% të votave.
- Një debat politik në PD lindi nga konflikti në këshillin bashkiak midis demokratëve dhe aleatëve të tyre, për shkak të aleancave fluide në votim me LSI. Marrëdhëniet zyrtare midis drejtuesve lokalë të PD dhe drejtuesve të PD në bashkinë Shtetëzë kanë shfaqur problematika, të cilat shpeshherë janë bërë lajme dhe në mediat lokale dhe qendrore. Ky është një tipar i zonave bastion, por sidomos kur partia drejtuese është në opozitë, dhe burimi i vetëm i emërimit të administratës është bashkia, jo dega partiake.
- Në tetor degët lokale Shkodër, Malsi e Madhe, etj, kanë nisur përgatitjet për strukturat në funksion të zgjedhjeve të ardhshme elektorale. Në funksion të tyre janë zhvilluar mbledhje të kryesive dhe të grupeve të punës, si dhe janë plotësuar strukturat rinore dhe të grave.
- Përsa i përket nivelit të transparencës me publikun, PD dega Shkodër ka një faqe në rrjetin social Facebook, ku reflektohen kryesisht aktivitete të këtij organizmi. Ajo nuk ka faqe në internet dhe nuk është shumë e pranishme në mediat qendrore, ndryshe nga sa ndodh me disa prej qyteteve të tjera të mëdha.

RAPORT MBI DBP NË PARTITË E TJERA TË BASHKISË SHKODËR

- Në Shkodër LSI ka një bazë të qëndrueshme, kryesisht për shkak të numrit të lartë të votave më 2013. LSI zgjodhi një deputet në Shkodër (Agron Çela), merita e të cilit dhe jo e strukturës së LSI, ishin përcaktuese në fitoren e këtij mandati. I njëjti trend u ruajt edhe në zgjedhjet lokale 2015 ku LSI fitoi 10 vende në këshillin bashkiak, numër rekord për një parti të tretë politike.
- Procesi më i rëndësishëm i votimit lidhet me votën për kryetar të LSI dhe delegatë në Kongres. Më 6 nëntor, në votimin në Shkodër u thirren 3500 anëtarë dhe Meta rezultoi fitues me shumicë absolute votash. Vlen të theksohet se LSI nuk ka zhvilluar zgjedhje për kryetar dege, por ka mbajtur konventën rinore. Në maj rreth 250 të rinj votuan kryetarin e ri lokal të LRI, Eduina Ymeri. Më 11 Korrik u mbajt edhe konventa rinore për Pukën, ku përsëri fituese u shpall një vajzë, Romina Kuçi.
- Gjatë periudhës së monitorimit LSI dhe partitë e vogla në Shkodër kanë qenë edhe pjesë të debateve rreth ligjit të ri elektorale, dhe problematikeve të ndryshme që lidhen specifikisht me Shkodrën. Një sërë procesesh të tjera në partitë e vogla politike të Shkodrës, që lidhen me zgjedhje ose emërim kryetarësh, me ndryshime në struktura, apo me mbledhje organizimi në prag të fushatës elektorale, janë tregues minor të aktivitetit të partive të tjera politike në Shkodër, por edhe tregues simbolikë për mungesën e standardeve të demokracisë partiake.

■ RAPORT: PARTITË DHE FINANCIIMI 2016

Hartuar nga Ervin KARAMUÇO, ekspert i Institutit të Studimeve Politike

- Përpjekje të vazhdueshme duhet të ndërmerren në pikëpamjen ligjore dhe lidhur me rregullat e tjera, të cilat janë të domosdoshme për të garantuar barazi financiare dhe konkurrencë të drejtë ndërmjet partive politike dhe kandidatëve të tjera të pavarura. Aktualisht rregullat e garimit politik shprehin një pabarazi të theksuar që vjen në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe rendin juridik në tërësi.
- Ligji Për Partitë Politike duhet të amendohet me dispozita shtesë të detyrueshme për aktivitetet e partive politike, që kanë të bëjnë me vetë-publikimin e pasqyrave financiare, informacioneve në lidhje me anëtarët e tyre, nivelin e kuotizacioneve që derdhen, bilancet periodike, të ardhurat dhe shpenzimet si dhe donatorët e fushatave dhe ata që ofrohen gjatë viteve jo zgjedhore.
- Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesit, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe organet e tjera ligj-zbatuese në këtë fushë, duhet të jetë më efektive në hetime gjithëpërfshirëse të koordinuara në lidhje me rastet e financimit të dyshimtë të partive politike, duke zbuluar burimin e të ardhurave.
- Rastet e denoncimeve publike të blerjes së votave, kërcënimeve të tjera apo sulme fizike që ndodhin në jetën politike dhe abuzimet me përdorimin e rezervave shtetërore ose publike gjatë fushatave, duhen të jenë në fokusin e organeve ligj-zbatuese për t'i parandaluar në kohë dhe për të ndëshkuar personat përgjegjës me ose pa imunitet.
- Dispozitat ligjore në fuqi lidhur me organizimin dhe funksionimin e partive politike nuk mundësojnë rregullime të detajuara nëse regjistrat financiarë duhet të mbahen për një afat kohor të parashikuar ose duhet të asgjësohen menjëherë. Mos parashikimi i kësaj norme bën të mundur që subjektet politike në rastet e financimeve të dyshimta ta kenë të lehtë ti shpëtojnë hetimeve të mëvonshme që mund të zhvillohen për raste të tilla.
- Partitë politike në Shqipëri nuk i publikojnë vetë deklaratimet financiare për publikun e gjerë, si dhe për anëtarët e tyre. I vetmi informacion është ai i mundësuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe i publikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ. Mungesa e transparencës në këtë aspekt është flagrante dhe nuk mundëson një akses publik të qytetarëve mbi partitë politike të cilat nesër mund të marrin në dorë fatet e vendit.
- Në faqet zyrtare të internetit të partive politike në Shqipëri nuk ekziston asnjë informacion i vlefshëm lidhur me financimet e partisë, donatorët, kuotizacionet financiare etj. Ka raste si LSI që ka shënuar risi në publikimin e disa të dhënave financiare (2016), por edhe ato dominohen nga të dhëna formale dhe kryesisht sponsorizime e nisma vullnetare, jo tipike për partitë politike. Në të gjitha partitë anëtarët e konsiderojnë të vështirë sigurimin e informacionit mbi fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partia e tyre.
- Me ligjin mbi të drejtën e informimit, transparenca publike është bërë kriter vlerësimi dhe standard baze për çdo institucion publik, partitë politike si organizata që kryejnë aktivitet kushtetues dhe kanë të përfshirë funksionare publikë. Vetë partitë janë gjenerues dhe monitorues të këtij ligji, por në paradoks me sa më lart, ato nuk kanë përmbushur asnjë lloj standardi në këtë aspekt. Partitë vijojnë të jenë të mbyllura për publikun dhe janë hermetike për transparencën dhe llogaridhënien publike.
- Legjislacioni shqiptar mbi partitë politike është i paplotë dhe konfuz. Nga monitorimi i kryer nga ISP vetëm 12 nga 126 partitë politike të regjistruara në gjykatë kanë raportuar periodikisht ndryshmet që kërkohen nga ligji. Pjesa tjetër e partive e ka injoruar detyrimin ligjor, disa parti politike figurojnë ende aktive me drejtues të cilët as nuk jetojnë më. Fiktiviteti i partive politike pranohet edhe nga KQZ, organ i cili në raportin vjetor 2015 thekson se nga 118 parti politike të

cilat duhet të auditoheshin, 71 parti politike nuk u arrit të kontaktoheshin nga ekspertët kontabël të kontraktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

- Referuar standardit minimal të informimit publik, qofte edhe për aspektin financiar, pjesa më e madhe e këtyre partive nuk kanë faqe interneti, nuk kanë media dhe as burime të tjera publike informimi mbi programin, strukturat, aktivitetin dhe të dhënat e tyre financiare. Partitë kryesore parlamentare: PS, PD, LSI, PDIU kanë faqe interneti, pjesërisht të përditësuar. Partitë e tjera në parlament PDK, PBDNJ, etj, kanë faqe in-aktive interneti, kurse partitë e mbetura, LZHK, PR, PAA, etj, nuk kanë adrese efektive në internet.
- Partitë Politike në shumicën e rasteve janë evidentuar se depozitojnë me vonese ose nuk depozitojnë asnjëherë pasqyrat financiare në KQZ. Ligji nuk parashikon një afat për depozitim të pasqyrave financiare të vete-deklarimit nga ana e partive politike dhe një boshllëk i tillë shfrytëzohet me abuzivizem nga shumë subjekte politike. Në këto raste nuk janë evidentuar sanksione apo masa të tjera administrative në ngarkim të tyre. KQZ ka një rol të konsiderueshëm për auditimin e partive politike por kapacitetet e saj janë të pamjaftueshme dhe një mision i tillë mbikëqyrës është i pa realizueshëm.

HYRJE

Mbarëvajtja e veprimtarisë politike, në kuadër të financimit të partive politike shqiptare, mbetet një indikator me rëndësi kombëtare për forcimin e demokracisë, shtetit ligjor, dekriminalizimit të politikës dhe katarsisit ndaj praktikave politike të kundraligjshme në Shqipëri. Në zgjedhjet politike të vitit 2013 dhe zgjedhjet administrative të vitit 2015, partitë politike në Shqipëri vijuan të denoncohen në raportet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare për probleme lidhur me transparencën e financimit dhe sponsorizimit të veprimtarisë së tyre. Po ashtu me gjithë ndryshimet ligjore në vitin 2011 dhe 2014 në ligjin për Partitë Politike, vërehet se nuk ka një zgjidhje të përhershme të të gjitha problemeve të financimit dhe transparencës në këtë fushë, çka ngre shumë dyshime për një garë të pandershme politike dhe për konsumimin e praktikave të parregullta ose me natyrë kriminale të tyre.

Në mars 2016 Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e Fondacionit Fridrich Ebert mori iniciativën e realizimit të database mbi partitë politike, zgjedhjet dhe institucionet politike në Shqipëri. Ky projekt përbën rastin e parë të publikimit të dokumenteve kryesore të partive politike prej vitit 1990. Database mbetet një arkiv dedikuar partive politike, medias, studentëve të shkencave politike, OJF-ve që veprojnë në këtë fushë, si dhe grupimeve e individëve të tjerë të interesuar mbi problematikat e organizimit dhe funksionimit të partive politike.

Në kuadër të këtij projekti, krahas publikimit të dokumenteve themelore të partive politike, statuteve dhe programeve, zgjedhjeve dhe zhvillimeve të brendshme, një vend të veçantë zënë praktikatat e financimit dhe problematikat e hasura në jetën politike të vendit. Database www.politike.al është munduar të reflektojë krahas të tjerash edhe praktikatat më të mira të financimit të partive politike në vendet rajonale dhe evropiane, studimet profesionale mbi legjislacionin shqiptar dhe evropian mbi partitë politike, zgjedhjet, si dhe aspekte të veçanta të studimit të raportit dhe aktivitetit të partive politike.

- Materialet për problematikat mbi financimin e partive politike janë siguruar së pari përmes raporteve zyrtare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe të raporteve të posaçme të hartuara nga auditues të licencuar që janë punësuar me kohë të pjesshme nga ana e KQZ. Ndërkohë burime të tjera për njohjen me gjendjen e praktikave të financimit janë shfrytëzuar edhe raportet e organizatave ndërkombëtare ku bëjnë pjesë kryesisht OSBE, Këshilli Evropës dhe Komisioni Evropian BE.
- Materiale të tjera janë siguruar nëpërmjet studimit dhe hulumtimit të faqeve të internetit të partive politike dhe çdo burimi tjetër që shfrytëzohet nga ana e tyre për përmbushjen e detyrimit të transparencës ndaj publikut dhe institucioneve shtetërore.

■ TE DREJTAT DHE DETYRIMET KUSHTETUESE DHE LIGJORE PER FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE

- Neni 9 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon që partitë politike duhet të organizohen në përputhje me parimet demokratike, dhe që burimet financiare e shpenzimet e tyre të bëhen kurdoherë publike. Në bazë dhe për zbatim të kësaj dispozite, legjislacioni mbi partitë specifikon parime e standarde që lidhen me rregullat demokratike të funksionimit, por nuk ka krijuar mekanizma institucionalë të monitorimit të zbatimit të ligjit, përveç Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i cili kontrollon vetë-deklarimet e partive politike nëpërmjet audituesve të licënuar.
- Financimi vjetor i aktivitetit të partive politike rregullohet me ligjin nr. 8580 datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, të ndryshuar. Ligji “Për Partitë Politike”, kufizon në Nenin 21 të tij, partitë politike që përfitojnë dhurime financiare e materiale nga qeveri, entitete publike ose private të huaja. Ky nen lejon dhuratat ose ndihmat që vijnë nga parti apo unione ndërkombëtare partiake, organizata apo fondacione politike, shqiptare dhe të huaja, individë, person fizik apo juridik shqiptar. Ligji parashikon se dhurimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100,000 Lekë (rreth 720 Euro), duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme, të hapur në një bankë nga partia politike. Gjithashtu, ndalohet përfitimi i fondeve jopublike, kryer nga subjekte që nuk deklarojnë identitetin e tyre apo identiteti i të cilave është i papërcaktuar qartë nga partia politike përfituese e fondit jopublik.
- Sipas ligjit për partitë politike ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksioner i tij në rast se ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 000 000 Lekë, ushtron veprimtari në fushën e medias, ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme, ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.
- Lidhur me ndihmat publike të financimit, Ligji “Për Partitë Politike” parashikon se çdo vit në Buxhetin e Shtetit caktohet një fond ndihme financiare për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike. Kjo ndihme financiare pasqyrohet në Buxhetin e Shtetit për vitet jo-zgjedhore. Partive parlamentare u mundësohet një ndërtesë për zyrat e tyre qendrore dhe lokale. Kjo mundësi u jepet edhe partive politike, mesatarja e votave të të cilave ka qenë më e madhe se 1 % në rang kombëtar në tre zgjedhjet e fundit parlamentare. Kur nuk ka ndërtesa të lira për këtë qëllim, shteti merr përsipër pagesën e qirasë së selisë qendrore dhe të zyrave vendore të partisë politike.
- Subjektet zgjedhore mund të marrin fonde, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t’i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlefata në sende ose shërbime. Shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas Kodit Zgjedhor.
- Lidhur me financimin e fushatave zgjedhore, ligji parashikon se partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 0,5 për qind të votave në shkallë vendi, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje. Fondi përcaktohet me vendim të Kuvendit dhe përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit. KQZ-ja, përcakton me vendim vlerën në para të një vote të vlefshme, duke pjesëtuar fondin e përgjithshëm të miratuar, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e radhës, që kanë fituar jo më pak se 0,5 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi.

■ KONTROLLI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PER FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE

- Kodi Zgjedhor përcakton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive dhe fushatave zgjedhore. KQZ përzgjedh listën e ekspertëve kontabël të licencuar dhe i cakton me short ata për auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të partive politike, si dhe mbikëqyr financimin e partive politike, nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit financiar e të llogarive kontabël të partive politike. KQZ vendos sanksione kur konstaton shkelje të ligjit dhe përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore. Ky institucion është gjithashtu përgjegjës për organizimin e programeve ndërgjegjësuese dhe trajnimeve për financimin e partive politike dhe të subjekteve të përfshira në këtë proces, sipas dispozitave të këtij ligji.
- Ligji “Për Partitë Politike” i detyron partitë politike në Shqipëri të mbajnë librat e kontabilitetit të brendshëm dhe të raportojnë mbi asetet që disponojnë, të ardhurat dhe shpenzimet. Partitë duhet të dorëzojnë raportet financiare një herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), së bashku me raportin e auditimit të përgatitur nga kontabilistë të certifikuar. Raportet financiare vjetore përgatiten, nënshkruhen dhe dorëzohen nga personi përgjegjës për financat në partinë politike apo personi i zgjedhur sipas përcaktimit në Statutin e partisë. Në rastet e vitit elektoral, raporti financiar vjetor i partisë duhet të dorëzohet së bashku me raportin financiar të fushatës elektorale. Raporti financiar vjetor, raporti i auditimit dhe raporti i KQZ duhet të publikohen në faqen zyrtare të internetit të KQZ jomë vonë se 30 ditë nga data e dorëzimit të tyre pranë KQZ.
- Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e ndaluesë të Kodit Zgjedhor dhe mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë.
- Jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, KQZ-ja emëron me short një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore. Subjektet zgjedhore duhet të vënë në dispozicion të auditit të emëruar nga KQZ-ja çdo informacion, dokumente apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore. KQZ-ja publikon raportet e auditimit për subjektet zgjedhore jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga data e mbylljes së verifikimeve përkatëse. Emri i personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse publikohen bashkë me raportin.
- KQZ-ja përzgjedh me konkurrim një listë të ekspertëve kontabël të licencuar në fillim të vitit zgjedhor. Lista duhet të përmbajë të paktën 20 ekspertë, të cilët e ushtrojnë këtë profesion në 5 vitet e fundit. Procedurat, kriteret e përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të tyre përcaktohen me udhëzim të KQZ-së. Në çdo rast një auditor nuk mund të auditojë të njëjtin subjekt zgjedhor për dy zgjedhje radhazi.

SANKSIONET DHE KUFIZIMET E PARTIVE POLITIKE GJATE FUSHATAVE ELEKTORALE LIDHUR ME FINANCIMIN DHE SHFRYTEZIMIN E PALIGJSHEM TE ASETETEVE PUBLIKE

- Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. Burime quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe çdo

burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore.

- Burimet e financimit të fushatës për subjektet zgjedhore janë fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit, dhuratat në vlerë monetare, natyrë ose shërbime të dhëna dhe kreditë e marra nga partitë politike sipas ligjit.
- Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.
- Ligji Kodi Zgjedhor parashikon se shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në partinë politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50,000 deri në 100,000 Lekë. Shkelja e detyrimit për bashkëpunim me ekspertin kontabël të licencuar, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga ana e partisë politike, dënohet me gjobë nga 1,000,000 deri në 2,000,000 Lekë. Refuzimi për të bërë transparente burimet e financimit të partisë politike apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e ekspertit kontabël të licencuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 2,000,000 deri në 5,000,000 Lekë ose/dhe me pezullimin deri në 5 vjet të financimit publik për partinë politike.
- Shkelja e afatit të dorëzimit të raportit financiar në kohën e duhur apo paraqitja e raporteve në shkelje të formateve të standardizuara, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 50,000 deri në 100,000 Lekë. Fondet jopublike të përfituara nga partia politike, kur identiteti i dhuruesit nuk njihet apo nuk është i përcaktuar qartë, kalojnë për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pranimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100,000 Lekë dhe kur transaksioni nuk është kryer nëpërmjet llogarisë bankare dënohet me gjobë në masën 30 % të shumës së dhuruar.

DOMOSDOSHMERIA E FINANCIMIT TE PARTIVE POLITIKE

- Modeli shqiptar për financimin e partive politike është ndjekur si shembull marrë nga mjaft vende të tjera në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Në vështrim të përmbushjes së nevojave për zbatimin e drejtë të kushtetutës në kuadër të financimit të partive politike, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me Vendimin e saj Nr. 28/2012 është shprehur se edhe pse në parim mbështetja financiare e shtetit ndaj partive politike ka rëndësi në një shtet të së drejtës, kjo megjithatë nuk nënkupton që ajo nuk ka kufij, ajo nuk mund të tejkalojë një masë që respekton parimin e ndarjes së partive politike nga shteti.
- Gjykata vlerëson se kjo mbështetje financiare e shtetit mund të kufizohet mbi bazën e kontributit të partive politike, duke e vlerësuar atë në termat e “seriozitetit të përpjekjeve të partive konkurruese” ose të “*seriozitetit të qëllimeve elektorale të partive*” që shpreh një shkallë të përfaqësimit të tyre. Qëllimi i financimit nuk mund të jetë kufizimi i konkurrimit të lirë por ai duhet të sigurojë seriozitetin e kësaj gare. Ai nuk është një instrument për integrimin e partive politike, por thjesht një përcaktues i faktit nëse programet zgjedhore kanë pasur qëllime serioze, nëse ato janë orientuar ekskluzivisht drejt suksesit të zgjedhjeve dhe jo ndaj qëllimeve të tjera.
- Në kontekst të vendimit të mësipërm Gjykata Kushtetuese ka paraparë të nevojshme të sqarojë një ekuilibër të brishtë midis nevojës për të financuar partitë politike nga njëra anë dhe seriozitetit të

veprimtarisë së tyre nga ana tjetër me qëllim që ky financim të vlejë si një e mirë publike në shërbim të qytetarëve. Financimi i partive politike në aspektin teorik mundëson parandalimin i abuzivizmit në veprimtaritë politike me fonde të fshehta, garanton një konkurrim politik të drejtë dhe të ndershëm, konsolidon besimin e votuesve për rregulla ligjore të transparencës dhe ndëshkimit ndaj rasteve abuzive, si dhe afirmon partitë politike si faktor të rëndësishëm të demokracisë nëpërmjet forcimit të integritetit dhe praktikave të ndershme të organizimit të brendshëm.

- Sipas teorive moderne të lidërshpimit dhe organizimit të subjekteve politike financimi i partive politike përbën një kosto të nevojshme për forcimin dhe konsolidimin e demokracisë. Kjo formë e financimit më transparencë dhe rregulla të qarta ul ndikimin dhe influencën e kapitalit dhe shkëmbimit të paligjshëm të parasë mbi politikën dhe për pasojë redukton ndjeshëm fenomenet e korrupsionit brenda radhëve të partive politike.
- Nëpërmjet financimit të partive politike shteti shfrytëzon këtë rol për tu kërkuar subjekteve politike ndryshime apo reforma në jetën politike dhe fushave të tjera prioritare. Financimi publik në këtë rast rrit transparencën, sepse ai i nënshtrohet rregullave dhe parimeve të përgjithshme të shpenzimeve publike.
- Në rastet kur mungon financimi publik i partive politike dhe këto të fundit vete financohen privatisht, pabarazia ekonomike në shoqëri reflektohet edhe në pabarazi politike në qeverisje dhe në garat elektorale. Partitë politike dhe kandidatët për shkak të rritjes së kostove gjate fushatave e kanë nevojë jetike mbështetjen financiare. Në shoqëritë në zhvillim dhe me nivele të larta varfërie, qytetarët nuk posedojnë mundësi për të kontribuar mjaftueshëm për mbështetjen financiare të partive politike, ndaj ky rol domosdoshmërisë që bie mbi shtetin si një rregullator i madh.

PROBLEMTIKAT E FINANCIIMIT TE PARTIVE POLITIKE NE SHQIPERI

- Fenomeni pabarazi ndërmjet partive politike shfaqet sidomos kur partitë më të mëdha, në disa raste, janë raportuar se përdorin automjetet publike dhe ndërtesat zyrtare për qëllime fushate, e cila është e ndaluar me ligj. Disa herë ceremonitë e qeverisë u pasua nga reklamat e fushatës së partisë në pushtet, duke e detyruar disa pjesëmarrjen e nëpunësve civilë. Kjo ka krijuar konfuzion në përcaktimin e linjave të qarta midis institucioneve shtetërore dhe interesave partiake, duke sfiduar edhe standardet ndërkombëtare, sipas raporteve të OSBE-së⁴. Sa i përket partive të reja ose kandidatëve të pavarur që marrin pjesë për herë të parë në një fushatë zgjedhore, raportet në përfundimin e zgjedhjeve kanë evidentuar një mungesë totale të ndihmës financiare nga buxheti i shtetit⁵.
- Sipas auditimeve të zgjedhjeve të dorëzuar në KQZ, janë vërejtur nivele të larta të shpenzimeve të papaguara sidomos të reklamave politike në transmetimin televiziv⁶. Rezultatet e tjera të treguara nga raportet e auditimit pasqyrojnë shqetësimin se shpenzimet kanë tejkaluar të ardhurat totale, ndërsa mjetet janë të pamjaftueshme ndërkohë që shpenzimet kanë qenë të pajustificuara⁷.
- Transparenca e financimit të partive politike është një çështje që edhe pse e rregulluar me ligj, hetime të dobëta administrative janë ndërmarrë deri më tani ku autoritetet publike janë bazuar vetëm në të dhënat e dorëzuara nga palët ose nga vetë-deklarimet e tyre. Në këtë aspekt, sanksionet e parashikuara në ligj janë të parëndësishme për të zbatuar transparencë të plotë dhe vullneti për t'i implementuar ato nga KQZ-ja mungojnë për shkak të ndikimit politik.
- Partitë politike konsiderohen transparente sipas ligjit, me detyrimin për të publikuar tri raporte, në mënyrë eksplicite, raportin vjetor financiar, raportin e auditimit të ekspertëve të certifikuar kontabël të caktuar nga KQZ-ja dhe raportin e auditimit të fushatës zgjedhore. Detyrimi i tyre i dorëzimit të raporteve të KQZ-së, është konsideruar në vijimësi i porealizueshëm nga shumica e partive politike

⁴OSCE/ODIHR 2013 Election Observation Mission Final Report, Albania, page 2: <http://www.osce.org/odihr/elections/106963?doenload=true>

⁵ CSCE/OSCE 1990 Copenhagen Document, paragraph 5.4: <http://ëëë.osce.org/odihr/elections/14304?doenload=true>

⁶ Audit RaportsPS dhe PR: http://www.cec.org.al/index.php?option=com_content&view=article&id=368%3Araportet-e-auditimit-te-subjekteve&catid=131%3Afinancimi-i-subjekteve&Itemid=323&lang=sq

⁷Audit Report LSI: http://www.cec.org.al/images/stories/zgjedhje-per-kuvend/2013/rap_audit/LSI.pdf

dhe një numër i vogël i tyre kanë përmbushur dispozitat ligjore për të gjitha raportimet.

- Raportet e auditimit për periudhën zgjedhore, janë realizuar përgjithësisht nëpërmjet procedurave të formale nga pothuajse të gjitha partitë dhe madje edhe nga kandidatë të pavarur. Megjithatë, pavarësisht nga detyrimet e tyre në dorëzimin e raporteve në KQZ, konstatohet se korniza ligjore që përcakton këtë detyrim nuk parashikon afate specifike për dorëzimin e tyre nga partitë politike.
- KQZ-ja është përgjegjëse për publikimin e raporteve brenda 30 ditëve nga paraqitja e tyre dhe zbatimi i këtij detyrimi realizohet vetëm nëpërmjet publikimit të tyre në faqen e internetit zyrtar të këtij institucioni. Ndërkohë, partitë politike nuk bëjnë publike raportet e tyre financiare me anë të mjetet e tyre të informacionit dhe ka mungesë të rregullave në lidhje me mënyrën dhe afatet e përmbushjes së kësaj transparence. Kjo çështje është ngritur edhe në raporte ndërkombëtare, ku shqetësimi për transparencën e partive politike ka qenë i lidhur me neglizhencën e tyre në procesin e vetë-informimit publik⁸.
- Në përgjithësi eëbsite i KQZ-se është lehtësisht i aksesueshem nga publiku në lidhje me pasqyrat financiare të deklaruara nga partitë politike. Megjithatë mbeten shqetësim ato raporte financiare të cilat për shkak të vonesave apo procedura të tjera burokratike nuk janë bere kurrë publike në faqen e internetit të KQZ-së ose nëpërmjet buletineve (*hard copy*). Në këtë aspekt nuk janë evidentuar përpjekje zyrtare të KQZ për të marre masa për publikimin e tyre të mëvonshëm ose për masa me karakter administrativ ndaj subjekteve politike të veçanta.
- Praktika në lidhje me donacionet dhe fondet mbështetëse që vijnë nga individë privat apo subjekte të tjera është përmirësuar për shkak të përpjekjeve të partive politike që të pasqyrojnë plotësisht gjeneralitetet dhe shumën e donacioneve në llogarinë bankare zyrtare të tyre. Gjithsesi, problem mbetet autenticiteti i dyshimtë i deklaratave dhe fondeve që fshehin donatorët e vërtetë të cilët shmangin të përballen me hetime të mëtejshme nga auditimi. Ky shqetësim përfshin edhe donacione në natyrë të cilat nuk janë të janë pasqyruar në pasqyrat financiare të partive politike.
- Edhe pse raportet financiare përfshijnë informacione shtesë të detajuara mbi donacionet, të tilla si, emrin e donatorëve, data dhe shumën e çdo dhurimi, kopje të faturave për çdo shpenzim, datën dhe shumën e shpenzimeve dhe emrin dhe numrin e regjistrimit të çdo shitësi zyrtar, në praktikë parregullsitë nuk janë raportuar kurrë për tu shoqëruar me tej me sanksione⁹.
- Edhe pse KQZ është mbikëqyrëse, duke vënë sanksione dhe duke bërë publike të gjitha raportet të subjekteve politike në lidhje me veprimtarinë e tyre brenda 30 ditëve nga paraqitja, ligji nuk parashikon ndonjë afat për dorëzimin e deklaratave. Ky boshllëk ka krijuar konfuzion në lidhje me procedurat konkrete ligjore të trajtimit të rasteve të vonesave dhe sanksioneve ndaj partive politike.
- Megjithëse Gjykata Kushtetuese vendosi të përjashtojë Kontrollin e Lartë të Shtetit nga kontrolli i aktiviteteve financiare të partive politike, duke ja lenë këtë kompetencë KQZ-së, kjo e fundit nuk ka treguar kapacitet e plotë për të siguruar rregullsinë e raporteve financiare dhe kontrollin e tyre edhe në mënyrë pro-aktive. Ky pasivitet është nënkuptuar edhe për shkak të përbërjes së KQZ-së me përfaqësues të forcave kryesore politike, të cilët favorizojnë në qëndrimet e tyre subjektet politike që përfaqësojnë.
- Komisioni Evropian ka shprehur shqetësime në lidhje me financimin e partive politike, duke sugjeruar se KQZ-ja ka nevojë për të nisur inspektime të konsiderueshme, duke shkuar përtej një qasjeje thjesht formal për të kontrolluar deklaratat e partive politike, dhe për të vendosur përgjegjësitë brenda të qarta për mbikëqyrjen e financave të partive politike¹⁰.



⁸ Transparency International Albania, CRINIS report, "Buying Influence: Money and Political Parties in Albania"; page 19: http://www.transparency.org/files/content/feature/2013_CRINIS_Albania_EN.pdf

⁹ Transparency International Albania, 2013 CRINIS report, "Buying Influence: Money and Political Parties in Albania"; pages 17, 21: http://www.transparency.org/files/content/feature/2013_CRINIS_Albania_EN.pdf

¹⁰ European Commission, 2014 Progress Report, Albania, page 44: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf

SHTOJCE

AKTET E KRIJIMIT TË PARTIVE KRYESORE POLITIKE





SHTOJCE

DATABAZA POLITIKE.AL, NJE RISI NE JETEN PUBLIKE



Databaza www.politike.al nga Prilli 2016 ka qënë portali i vetëm online në dispozicion të studiuesve dhe pedagogëve të shkencave politike me informacion të plotë dhe të përditësuar mbi historikun, vendimmarrjen dhe demokracinë e brendshme të partive. Ky portal i ka shërbyer edhe vetë partive politike duke i nxitur për të qënë më transparente dhe më të kujdesshme me përditësimin e akteve, buxhetit dhe vendimmarjes së tyre.

Brenda tetë muajve Prill – Dhjetor ka pasur rreth 2000 vizitorë në faqen zyrtare dhe 62 persona të abonuar tek protali për të marrë njoftime mbi zhvillimet më të fundit dhe raportet tona periodike.

Cdo tre muaj raportet e politike.al dhe komentet e ekspertëve tanë mbi gjetjet estudimit janë pasqyruar në mediat më të njohura kombëtare.

Afrim Krasniqi

INTERNAL DEMOCRACY IN POLITICAL PARTIES IN ALBANIA ANNUAL REPORT - 2016

